

Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës miratoi plotësimet dhe ndryshimet e Propozicioneve të Garave paraprahe, bazuar në Nenin 2, pika c) dhe g), Nenin 41, pika c) dhe n), Nenin 49 dhe Nenin 77 të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës, të miratuar më 27.01.2023, dhe në mbledhjen e vet të mbajtur më 04 korrik 2023, aprovon:

## **PROPOZICIONET E GARAVE**

për Superligë, Ligën e parë, Ligën e dytë,  
Ligën e tretë, Junior dhe Kadetë  
Kampionati i Kosovës në Futboll 2023/2024

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

Me këto Propozicione, caktohet mënyra, organizimi dhe udhëheqja e garave të kampionatit të futbollit në Kosovë për të gjitha rangjet garuese.

Me Propozicione rregullohen veçanërisht garat kampionale të futbollit me sa vijon: mënyra e garimit, orarin e ndeshjeve, shtyrjen e ndeshjeve, fushat për zhvillimin e ndeshjeve, caktimin e fushave dhe fillimin e ndeshjeve, organizimin e ndeshjeve, të drejtën e pjesëmarrjes dhe identifikimin e identitetit të lojtarëve, delegatët, vëzhguesit dhe gjyqtarëve, ndalimin e zhvillimit të ndeshjeve në fushën e caktuar, kundërvajtjet disiplinore, ankesave me afate të veçanta në procedurë të ankesës, regjistrimet e ndeshjeve, miratimin e plasmanit, kontrollimet mjekësore, fanelat sportive (ngjyrat dhe numrat), pjesëmarrja me ekipin më të mirë, dorëzimet e ndeshjeve pa luftë, numri më i vogël i lojtarëve, rregullat financiare, shpërblimet, buletini zyrtarë, përtërirja e ligës dhe kushtet minimale për punët profesionale dhe pedagogjike

#### **Neni 2**

Garat e futbollit në Kosovë në të gjitha rangjet i organizon, drejton dhe kontrollon FFK-ja, përmes organeve të saj dhe Komisioneve, e sidomos atij të Organizativ të Garave dhe atij Disiplinor dhe të Etikës.

Me garat e futbollit në të gjitha rangjet (Superliga, Liga e I-rë, e II-të, e III-të, Liga e femrave, Futsall, junior, kadetë dhe garat e kategorive të reja) udhëheqin komisionet e garave të cilat i emëron dhe shkarkon Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, dhe Komisioni Organizativ i Garave unik për Superligë dhe Ligën e parë, Ligën e Dytë, Ligën e Juniorëve dhe Ligën e Kadetëve, ndërsa të tjerat i organizojnë Lidhjet Rajonale.

Komisionin Organizativ të Garave për rangun e ligës rajonale e cakton subjekti që udhëheq me gara.

### Neni 3

Garat kampionale të futbollit, do të zhvillohen sipas sistemit të Ligave, në të cilin do të marrin pjesë:

- Në Superligën e Kosovës garojnë 10 ekipe
- Në Ligën e Parë të Kosovës garojnë ekipet e ndara në dy grupe;
  - o Grupi; A me 10 ekipe (Rajoni i Mitrovicës, Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit).
  - o Grupi; B me 10 ekipe (Rajoni i Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit).
- Në Ligën e dytë të Kosovës garojnë 16 ekipe.
- Juniorët; Superliga, garojnë 16 ekipe.
- Juniorët; Liga e Parë, garojnë 16 ekipe (sipas paraqitjeve).
- Kadetët; Liga Nacionale; garojnë 16 ekipe.
- Ligat e treta - Seniorët; garojnë ekipet në kuadër të Lidhjeve Rajonale (minimumi 6 ekipe garuese për një grup).
- Ligat e grup moshave të reja (organizohen dhe udhëhiqen nga organet e Lidhjeve rajonale).

### Neni 4

#### **Superliga: 10 ekipe garuese**

Ekipet garuese:

- Drita
- Gjilani
- Ballkani
- Prishtina
- Llapi
- Dukagjini
- Malisheva
- Feronikeli
- Liria
- Fushë Kosova
- Liria

Sistemi i garave do të jetë ky: do të zhvillohen 36 xhiro për 4 (katër) rrathë; 9 + 9 + 9 + 9. Në stinorin vjeshtor zhvillohen dy rrathë me vajtje ardhje me gjithsej 18 xhiro sipas sistemit të Bergerit.

Edhe në stinorin pranveror zhvillohen dy rrathë me vajtje ardhje me gjithsej 18 xhiro (përsëritje e stinorit vjeshtor).

Takimet e ndërsjellat gjatë një kampionati do të jenë me nga katër ndeshje.

Në përfundimin e xhiros së 36, skuadra që fiton më së shumti pikë, fiton titullin e kampionit të Kosovës në futboll për kategorinë e seniorëve.

Dy skuadrat që fitojnë më së paku pikë duke i mbledhur pikët e 36 xhirove të rregullta të Superligës, do të kalojnë në rang më të ulët – Ligën e parë të Kosovës në futboll (vendi; 9 dhe 10), kurse ekipi i plasuar në vendin e 8-të, do të luaj ndeshjen e barazhit me fituesin e vendeve të dyta të grupit A dhe B të Ligës së Parë.

Pas zhvillimit të 36 xhirove të Superligës do të zhvillojë një ndeshje përcaktuese me fituesin e ndeshjes së barazhit të zhvilluar mes dy vendeve të dyta të Ligës së parë nga Grupi A dhe Grupi B, për ruajtjen apo fituesin e statusit në Superligë për edicionin vijues 2024-2025.

Ndeshja do të zhvillohet në terren neutral (e cakton KE i FFK-së). Nëse ndeshja kryhet barazi vijojnë vazhdimet 2 x 15 minuta, dhe nëse edhe atëherë nuk ka fitues ekzekutohen penalltitë.

Fituesi nga kjo ndeshje fiton statusin e anëtarit të Superligës për edicionin 2024-2025.

## **Neni 5**

### **Liga e parë, 20 ekipe të ndara në dy grupe:**

- a) Grupi; A me 10 ekipe garuese (Rajoni i Mitrovicës, Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit),
- b) Grupi; B me 10 ekipe garuese (Rajoni i Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit),

Ekipe garuese; Grupi; A (Dinamo, Rilindja 1974, Istogu, Vëllaznimi, Drenica, Trepça 89, Trepça, Phonixi, Suhareka 23, Rahoveci),

Ekipe garuese; Grupi; B (Flamurtari, Vjosa, Ramiz Sadiku, 2 Korriku, Vllaznia, Ulpiana, Kika, Vushtrria, Shkëndija, Ferizaj).

Do të zhvillohen 27 xhiro të rregullta për Ligën e parë për secilin grup në tri etapa sipas sistemit të Bergerit. Vajtje - ardhje (18 xhiro), ndërsa etapa e tretë do t'i ketë 9 xhiro në bazë të plasmanit kualifikues në tabelë dhe do të luhet sipas sistemit të Bergerit. Sipas kësaj; 5 ekipet e para do të kenë një ndeshje më shumë si vendas.

Skuadrat që fitojnë më shumti pikë (vendet e para), nga Grupi; A dhe Grupi; B (duke i mbledhur pikët e 27 xhirove të zhvilluara – rregullta, e fitojnë të drejtën për të kaluar në rang më të lartë – në Superligë, ndërsa vendi i dytë nga grupi; A dhe grupi; B luajnë ndeshjet vendimtare mes vete për të fituar të drejtën e zhvillimit edhe të një ndeshje me ekipin e plasuar në vendin e 8 të Superligës, ndeshje e cila do të zhvillohet në vend neutral i caktuar me një vendim të FFK-së.

Zhvillohet vetëm një ndeshje. Në rast së ndeshja përfundon pa fitues zhvillohet loja shtesë 2 x 15 minuta. Nëse edhe pas lojës shtesë 2 x nga 15 minuta nuk përcaktohet fituesi, atëherë bëhet ekzekutimi i penalltive. Fituesi i kësaj ndeshje fiton statusin e anëtarit të Superligës së Kosovës në futboll për kampionatin vijues 2024 – 2025.

Në fund të kampionatit; 2023-2024; 1 (një) skuadër e fundit nga tabelat treguese mbi plasmanin kualifikues të ekipeve nga Grupi; A dhe Grupi; B (vendi 10) nga të dy grupet që fitojnë më së paku pikë nga 27 xhirot e rregullta do të kalojnë në Ligën e dytë të Kosovës në futboll.

Duke filluar nga edicionin 2024/2025, Liga e Parë grupi A dhe B do të ketë ndryshime. Fituesit e Grupi A dhe B hyjnë direkt në superligë, vendet e dyta të grupit A dhe B zhvillojnë ndeshjet e barazhit në mes veti. Fituesi i barazhit zhvillon ndeshje me vendin e tete të Superligës. Vendet 9 dhe 10 në të dy grupet bien direkt në ligën e dytë.

Dy skuadrat e Ligës së dytë, vendi i parë dhe vendi i dytë hyjnë direkt në Ligën e Parë.

Liga e Parë do të jetë unik me 18 skuadra nga edicioni 2025/2026.

## **Neni 6**

### **Liga e dytë, 16 ekipe**

Garat në Ligën e dytë, zhvillohen me sistem të dyfishtë pikësh (vajtje-ardhje).

Do të zhvillohen gjithsej 30 xhiro të rregullta në dy stinore garuese; vjeshtë – 15 xhiro dhe stinorin pranverë 15 xhiro).

Në fund të kampionatit; 2023 – 2024, të dy ekipet e para që fitojnë më së shumti pikë duke i mbledhur pikët e 30 xhiro të rregullta të Ligës së dytë (kampioni dhe nën kampioni) e fitojnë të drejtën për të kaluar në një rang më të lartë – Ligën e parë të Kosovës në futboll për kampionatin vijues; 2024 – 2025.

Në fund të kampionatit; 2023-2024, nga Liga e dytë do të bien - largohen 2 (dy) ekipet që kanë plasmanin nga vendi; 15 dhe 16, rënia e tyre do të behët në Ligat e –III-ta, rajonale sipas përkatësisë dhe konfiguracionit të shtrirjes së tyre gjeografike.

Nga edicioni 2024/2025 do të ketë ndryshime, nga dy grupet A dhe B Liga e Parë, vendi 9 dhe 10 bien direkt në Ligën e Dytë (gjithsej 4 skuadra).

Dy skuadra nga Liga e Dytë, vendi i parë dhe vendi i dytë hyjnë direkt në Ligën e Parë.

Nga Liga e Dytë largohen vendi i 15 dhe 16, të cilat bien direkt në Ligën e Tretë.

Nga Liga e Tretë në Ligën e Dytë hyjnë dy skuadra (meqenese nuk dihet numri i skuadra në Ligën e Tretë, KE i FFK, vendos në lidhje me ecurinë e kualifikimit të skuadrave).

Tërheqja e shortit do të bëhet së paku 15 ditë nga dita e fillimit të edicionit paraprak të ligës përkatëse dhe fillimisht për Superligë pastaj për Ligat e Para, Ligën e Dytë, Superligën dhe Ligën e parë për kategorinë e Juniorëve dhe Ligën e Kadetëve në nivel Nacional.

Në short do të hyjnë vetëm ekipet e licencuara nga KE për rangun përkatës të garave. Për ekipet që nuk kanë licencë për garat përkatëse do të merr vendim të posaçëm KE-ja. Shortin e udhëheqin Komisionet që udhëheqin me gara.

## **Neni 7**

### **Juniorët (Superliga), 16 ekipe**

Garat e juniorëve janë plotësisht të pavarura nga garat e seniorëve dhe zhvillohen sipas kalendarit të posaçëm të përcaktuara me short.

Nëse një ekip i Juniorëve pa arsye nuk i zhvillon 3 (tri) ndeshje gjatë tërë kampionatit (vjeshtë pranverë) përjashtohet nga garat e mëtejme.

Në fund të kampionatit 2023 – 2024 nga Superliga; kategoria e juniorëve largohen; tre (3) ekipet e plasuara në fund të tabelës treguese; (vendi i 14,15 dhe 16) dhe kalojnë në Ligën e parë, ndërsa ato i zëvendësojnë tri (3) ekipet e plasuara në vendin e parë, dytë dhe tretë të Ligës së Parë.

Kampionati 2023-2024 i Superligës për kategorinë e juniorëve starton me 16 ekipe.

Garat e juniorëve në Superligë zhvillohen në 30 xhiro të rregullta me sistem të dyfishtë; vajtje - ardhje në dy stinore garuese dhe atë; vjeshtë 15 xhiro dhe pranverë 15 xhiro.

## **Neni 8**

Juniorët (Liga e parë); 16 ekipe (varësisht prej numrit të ekipeve pjesëmarrëse).

Afati i fundit për aplikimin e klubeve për t'u regjistruar në Ligën e parë të juniorët do të përcaktohet nga Komiteti Ekzekutiv.

Kushti për numrin e ndeshjeve në Ligën e parë – të juniorët është edhe licencimi i ekipeve, në të kundërtën ky numër mund të lëviz dhe të jetë më i vogël apo më i madh, varësisht nga interesimi dhe paraqitja e ekipeve.

Garat e juniorëve në Ligën e parë zhvillohen me sistem të dyfishtë; vajtje – ardhje me 22 xhiro të rregullta në dy edicione garuese; vjeshtë 11 xhiro dhe pranverë 11 xhiro (apo varësisht prej numrit të ekipeve të licencuara për gara të rregullta).

Nëse një ekip i Juniorëve në Ligën e parë, pa arsye nuk i zhvillon tri (3) ndeshje gjatë tërë kampionatit (vjeshtë pranverë) largohet nga garat e mëtejme dhe për të njëjtën aplikohen masat ndëshkuese sipas Rregullores Disiplinore.

Tri (3) ekipet e para (vendi parë, dytë dhe tretë) në fund të kampionatit plasohen (kalojnë) në Superligë – për kategorinë e juniorëve për edicionin vijues.

## **Neni 9**

### **Kadetët (Liga në nivel nacional), 16 ekipe**

Liga e kadetëve në nivel nacional organizohet me sistem të zhvillimit të ndeshjeve vajtje – ardhje për; 30 xhiro të rregullta (vjeshtë 15 xhiro dhe pranverë 15 xhiro).

Nëse një ekip i kadetëve pa arsye nuk i zhvillon tri (3) ndeshje gjatë tërë kampionatit (vjeshtë – pranverë) largohet nga garat e mëtejme dhe për të njëjtin aplikohen masat ndëshkuese sipas Rregullorës Disiplinore.

Në fund të kampionatit nga Liga e Kadetëve largohen; 3 (tri) ekipet të cilat janë të plasuara në tri vendet e fundit (14, 15 dhe 16), kurse vendet e tyre plotësohen me 3 (tri) ekipe po të kësaj grup moshe; fitueset nga turneu i Play-off-it i organizuar nga Lidhjet Rajonale.

Ekipe të cilat e humbin statusin e anëtarit të Ligës së Kadetëve (vendi i 14, 15 dhe 16) pas përfundimit të kampionatit, garat do t'i zhvillojnë në Lidhjet Rajonale prej nga ato gravitojnë (në kuadër të ligave përkatëse ekzistuese të kadetëve).

Ekipe të juniorëve, kadetëve ndeshjet i zhvillojnë në fushat ku zhvillohen ndeshjet e ekipeve të seniorëve, respektivisht në ato fusha të cilat janë të pranuar nga ana e komisionit përkatës të FFK-së.

Garat e grup moshave të reja; kadet në nivel Rajonal, pionieret, fatosat dhe para fatoset, organizohen dhe udhëhiqen nga Lidhjet Rajonale përkatëse.

Garat e kësaj grup moshe rregullohen me propozicionet e garave të grup moshave të reja; U-11,U-13,U-15 dhe U-17.

### **Neni 10**

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, i emëron Komisionet përkatëse të Garave në përbërje prej së paku 3 anëtarëve, të cilat do të udhëheqin me gara.

Garat e futbollit të Kosovës zhvillohen me sistem të dyfishtë (vajtje - ardhje), të trefishtë apo të katërfishtë, sipas kalendarit të garave, të verifikuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga KE i FFK-së.

Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas Rregullave ndërkombëtare të lojës së futbollit të aprovuara nga UEFA.

### **Neni 11**

Ndeshja zhvillohet në fushën të cilën e përcakton ekipi nikoqir para fillimit të Kampionatit e cila duhet të jetë e pranuar për atë rang të garave nga komisioni për pranimin e fushave. Ekipi nikoqir po ashtu në fillim duhet të përcaktojë edhe fushën alternative.

Me kërkesë të posaçme të cilën duhet ta aprovoj Komisioni Organizativ i Garave dhe lihet mundësia e ndryshimit të vendit (fushës) për atë ekip i cili nuk ka mundësi ta zhvillojë ndeshjen në fushën e vet. Por, ai ekip është i obliguar ta përgatitë fushën për lojë dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për organizimin dhe sigurimin e ndeshjes. Ekipi i cili nuk e përgatitë fushën për zhvillimin e ndeshjes (pastrimin nga të reshurat atmosferike, vizatimin me vija të dukshme etj...), të njëjtën e humb me rezultat zyrtarë, nëse vërtetohet se nuk ka ndërmarrë masat e parapara me rregullat e lojës së futbollit dhe obligimet që dalin nga to.

## **II. ORARI I GARAVE**

### **Neni 12**

Orarin e ndeshjeve e përcakton Komisioni Organizativ i Garave, më së voni 15 ditë para fillimit të garave (stinorit vjeshtor dhe pranveror), duke pasur parasysh kalendarin e garave të FFK-së, të cilin e miraton KE i FFK-së.

Orari i ndeshjeve përcaktohet me short, në prezencën e përfaqësuesve të klubeve, dhe duhet të bëhet së paku 15 ditë para fillimit të kampionatit (sistemi i Bergerit).

Gjatë tërheqjes së numrave për short, klubet që shfrytëzojnë të njëjtën fushë për ndeshje, apo që janë të të njëjtit qytet, dhe luajnë në të njëjtin rang garash, mund të kërkojnë shortin e dirigjuar, të cilin duhet ta aprovojë Komisioni, në mënyrë që të evitohet ndeshja e dy ekipeve që përdorin fushën e njëjtë në të njëjtën ditë.

### **Neni 13**

Ndeshjet kampionale zhvillohen të shtunave, të dielave apo edhe ndonjë ditë tjetër nëse për këtë vendos Komisioni Organizativ i Garave me kërkesën e kompanisë fituese televizive.

Komisioni Organizativ i Garave mund të vendos që ndeshjet e ndonjë xhiroje të luhen të mërkurën.

Klubet, para fillimit të stinorit (të vjeshtës apo të pranverës), me rastin e licencimit të klubit, duhet të propozojnë se a do të luajnë si nikoqir, të shtunën apo të dielën por të drejtën për të vendosur për ditën dhe orën e zhvillimit të ndeshjes e ka Komisioni Organizativ i Garave dhe KE, në raste të veçanta.

Klubi nikoqir, për ndeshje të caktuar, mund të propozon të ndryshojë terminin (nga e shtuna në të diel apo anasjelltas apo orën e zhvillimit të ndeshjes), me kusht që për këtë të paraqes kërkesë me shkrim (së bashku me arsyetimin përkatës) Komisionit Organizativ të Garave i cili është i obliguar që të njoftoj edhe klubin kundërshtar, 3 (tri) ditë para terminit të ri të ndeshjes.

Komisioni Organizativ i Garave mund të vendos që ndeshja e paraparë për të shtunën apo të dielën të zhvillohet gjatë një dite pune, sipas marrëveshjes me shkrim nga të dy klubet, të prezantuar në Komisionin Organizativ të Garave së paku 3 (tri) ditë para zhvillimit të ndeshjes dhe e vërtetuar nga ana e Komisionit Organizativ të Garave. Nëse nuk ka ankesa nga klubet tjera për atë ndeshje e cila mund të jetë e rëndësishme edhe për plasmanin e ndonjë ekipi tjetër. Marrëveshjet e këtilla, nuk do të pranohen për ndeshjet e tri xhirove të fundit të garave kampionale.

### **Neni 14**

Në interes të rregullsisë së garave, Komisioni Organizativ i Garave me pëlqimin e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, mund të vendos që ndeshjet e tri xhirove të fundit të kampionatit, të zhvillohen në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë.

## **III. SHTYRJA E NDESHJEVE**

### **Neni 15**

Shtyrjen e ndeshjes, mund ta lejojë vetëm Komisioni Organizativ i Garave, e në raste të veçanta edhe Komisioni për çështje urgjente i KE të FFK-së. (edhe KE).

**Ndeshja në mënyrë obligative shtyhet në këto raste:**

- kur është ditë zie.

- për shkak të fuqisë madhore (tërmeti, zjarri, vërshimet etj...).
- nëse ndeshja ka qenë e obligueshme të shtyhet për shkak të mungesës së personelit të deleguar (gjyqtarëve), e njëjta do të zhvillohet ditën e nesërme në të njëjtin vend dhe të njëjtën kohë, para fillimit të ndeshjes e cila luhet pas kalimit të ditës së zisë, mbahet një minutë heshtjeje në mënyrën e paraparë me rregullat e lojës së futbollit.
- Nëse ekipi i jep dy apo më shumë lojtarë për Reprerentacionin e Kosovës, për ta zhvilluar ndeshjen e paraparë të Reprerentacionit, atëherë kërkesa e Klubit mund të ndryshojë orarin e zhvillimit të ndeshjes Kampionale apo të Kupës.
- Komisioni Organizativ i Garave është i obliguar që, sipas kërkesës së ekipit të interesuar, të njoftoj ekipet dhe personat zyrtarë për shtyrjen e ndeshjes, gjegjësisht caktimin e terminit të ri për zhvillimin e ndeshjes dhe atë 3 ditë para zhvillimit të saj.

Ndeshja e shtyrë në mënyrën e sipërshënuar, duhet patjetër të zhvillohet në ditë pune para javës - xhiros së radhës. Shpenzimet për ndërrimin e orarit të garave, i bartë paraqitësi i kërkesës.

### Neni 16

Në rast se, ndeshja nuk zhvillohet për shkak të mosardhjes së organeve zyrtarë, (gjyqtarëve, delegatit), klubet kanë mundësi të bëjnë marrëveshje me shkrim mbi terminin e ri të ndeshjes, e kjo marrëveshje i përcillet Komisionit Organizativ të Garave, i cili duhet të vendosë për këtë.

Në rast të mosmarrëveshjes, lidhur me shpenzimet për shtyrjen e ndeshjes, vendos Komisioni Organizativ i Garave.

Në qoftë se, ndeshja e filluar ndërprerët për shkaqe të pa parapara (fuqia madhore) ndeshja do të filloj në atë minutë në të cilën është ndërprerë.

Për ndeshjen e vazhduar për shkaqe të ndërprerjes nga fuqia madhore, shpenzimet e veta të udhëtimit i bartë vet ekipi mysafir, ndërsa të personave zyrtarë i paguan klubi nikoqir.

### Neni 17

Plasmani i ekipeve, përcaktohet në bazë të pikave të fituara gjatë kampionatit. Për fitore ekipit i takojnë 3 pikë, për barazim të dy ekipet marrin nga 1 pikë ndërsa për humbje 0 pikë. Përcaktimi i renditjes tabelore detajisht përshkruhet në Rregulloren e Garave.

### Neni 18

#### Kohëzgjatja e ndeshjeve sipas grup moshave:

Nr.	Kategoritë	Kohëzgjatja e ndeshjës	Vazhdimet
1	Seniorët	2 x 45	2 x 15
2	Juniorët	2 x 45	2 x 15
3	Kadetët	2 x 45	2 x 10
4	Pionieret	2 x 35	2 x 05



5	Pionieret e rinj	2 x 30	2 x 05
6	Fillestarët	2 x 25	2 x 05
7	Para fillestarët	2 x 20	2 x 05
8	Femrat	2 x 45	2 x 15
9	Femrat; U-17	2 x 35	2 x 10
9	Futsal-i	2 x 20	2 x 05
10	Futbolli në rërë	3 x 12	1 x 03

#### IV. FUSHAT

##### Neni 19

Të gjitha klubet obligohen ti kenë fushat e veta apo të huazuara, në bazë të marrëveshjes, për çdo vit garues (të cilat duhet të mirëmbahen, të përgatiten për ndeshje, të pastrohen nga të reshurat atmosferike dhe të krijojnë kushtet për zhvillimin e ndeshjës së caktuar).

Mos ndërmarrja e masave për përgatitjen e terrenit për ndeshje (pastrimi, vizatimi, etj., sanksionon ekipin mikpritës me humbjen e ndeshjes me rezultat zyrtarë.

Secila fushë, duhet të jetë e regjistruar për zhvillimin e ndeshjeve për kategoritë përkatëse, me shenjë "kategoritë e ndeshjeve" të cilat mund të luhen në të.

Regjistrimin dhe kategorizimin e fushës, me Vendim të posaçëm, e bënë Komisioni për inspektimin dhe pranimin e fushave, të cilin e emëron Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Fusha e lojës (tereni) duhet të jetë nga bari natyral apo nga bari artificial i lejuar nga UEFA dhe komisioni për inspektim të fushave, ndërsa ngjyra duhet të jetë e gjelbër.

Proporcionet e fushës duhet të kenë standarde për gara ndërkombëtare: 105m x 68m. ose min.100m x 64m. (UEFA parasheh proporcionet edhe maksimale 120 x 80 metra). Klubi Futbollistik duhet të vërtetojë se në mënyrë ligjore ka të drejtën në shfrytëzimin e stadiumit (është pronar) ose se ka kontratë me shkrim me pronarin e stadiumit. Kriteret e UEFA-së, parashohin që çdo ekip i licencuar duhet të ketë edhe terrenet ndihmëse dhe objektet përcjellëse për ushtrime.

##### **Elementet kryesore në të cilat mbështetet inspektimi nga Komisioni i FFK-së:**

1. Shtyllat dhe këndet në përmasa standarde,
2. Fusha e mbuluar me bari,
3. Bankinat për vendas, mysafirë dhe personat zyrtarë, duhet të jenë sa më afër zveshtoreve,
4. Rrethoja e fushës,
5. Zhveshtorja për ekipin mysafir,
6. Zhveshtorja për ekipin vendas,

7. Zhveshtorja për gjyqtarë,
8. Zyra për personat zyrtarë,
9. Banjo dhe tualet për ekipin mysafir,
10. Banjo dhe tualet për ekipin vendas,
11. Banjo dhe tualet për gjyqtarë dhe personat zyrtarë,
12. Hapësira e caktuar për media

## **Neni 20**

### **Dimensionet e fushës duhet të jenë:**

- Superliga; standarde; 105 x 68 metra (e lejuar edhe me përmasa; maksimale; gjatësia 110 metra, kurse gjerësia 75 metra, kurse përmasat minimale; gjatësia 100 metra kurse gjerësia 64 metra).
- Liga e parë; standarde; 105 x 68 metra (lejohet edhe me përmasa; maksimale; gjatësi, 110 metra kurse gjerësia 75 metra, kurse përmasat minimale; gjatësia 100 metra kurse gjerësia; 64 metra)  
Liga e dytë; standarde; 105 x 68 metra (lejohen përmasat; maksimale; gjatësia 110 metra kurse gjerësia 75 metra, kurse përmasat minimale; gjatësia 100 metra, kurse gjerësia 60 metra).
- Liga e tretë e mëposhtme; standarde; 105 x 68 metra (lejohen përmasat; maksimale; gjatësia 110 metra, kurse gjerësia 75 metra, kurse përmasat minimale; gjatësia; 90 metra, gjerësia 60 metra)  
Juniorët, kadetët; standarde; 105 x 68 metra (lejohen përmasat; maksimale; gjatësia 110 gjerësia 75, minimale; gjatësia 90 metra, gjerësia 60 metra).
- Fusha e lojës, duhet të jetë e shënuar me vija të cilat nuk duhet të jenë më të gjera se 12 cm.
- Rradiusi (rrethi), i vijës së rrumbullaksuar në qendër duhet të jetë 9.15m.
- Shtyllat e golit (10-12 cm), duhet të vendosen në mes të qendrës së vijës së fundit dhe duhet të jetë e gjerë 7.32 m, dhe e gjatë 2.44 m. Ato duhet të jenë të përforcuara dhe siguruara mirë. Vija e parë prej portës (trashësia 10-12 cm) për në qendër duhet të jetë 5.5m ndërsa e dyta 16.5 m.
- Pika e Penalltisë duhet të shënohet në largësi prej 11 metrave dhe në qendër.
- Flamuri i kornierit, duhet të vendoset në të katër anët me lartësi prej 1.5m ndërsa radiusi i rrethit të kornierit duhet të jetë 1 m. Flamujt preferohet të vendosen edhe në të dy skajet e qendrës së fushës mirëpo gjatësia duhet të jetë 1 m.

## **Neni 21**

### **Detyrat e organizatorit të ndeshjës:**

1. Organizimin e ngjarjeve sportive e bënë Federata e Futbollit e Kosovës.
2. Organizimin e ngjarjeve sportive mund ta bëjnë klubet sportive, organizatat e sportistëve shoqatat e sportistëve edhe personat fizikë apo juridikë që paraprakisht kanë bërë marrëveshje me Federatën e Futbollit e Kosovës.
3. Organizatori i ngjarjeve sportive është i obliguar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e ngjarjes sportive, e në veçanti duhet të kujdeset për masat parandaluese të shfaqjes së dhunës dhe sjelljeve të palejuara.

**Të gjithë organizatorët e ngjarjeve sportive në futboll, përpos që implementojnë dispozitat obligative nga aktet normative të FFK-së, iu nënshtrohen edhe Ligjit mbi parandalimin e dhunës dhe dukurive negative në sport e sidomos në kapitujt:**

- Dhuna, sjelljet e palejuara, kurdisjet dhe dukuritë negative në ngjarjet sportive,
- Masat organizative,
- Masat preventive,
- Obligimet e organizatorit në ngjarjet sportive me rrezikshmëri të lartë,
- Obligimet e organizatorit për mbajtjen e evidencave përkatëse,
- Obligimet e organizatorit për sigurimin e kushteve teknike,
- Masat të cilat i ndërmarrin organet shtetërore kompetente,
- Bartja e shpenzimeve lidhur me masat e shqiptuara,
- Masat disiplinore dhe direktivat,
- Masat disiplinore kundër anëtarëve dhe klubeve, etj...

## **V. CAKTIMI I FUSHËS DHE FILLIMI I NDESHJES**

### **Neni 22**

Orarin dhe kohën e zhvillimit të ndeshjeve, veçanërisht për çdo javë-xhiro e cakton Komisioni Organizativ i Garave një javë para zhvillimit të ndeshjeve, duke pasur parasysh kërkesat dhe mundësitë e klubeve.

Orari i ndeshjeve i përcaktuar sipas këtij neni, mund të ndryshohet nga shkaku i fuqisë madhore apo ndonjë rasti të jashtëzakonshëm, më së voni 3 ditë para ndeshjes, e lidhur me të, duhet të lajmërohen klubet si dhe organet zyrtare të ndeshjes.

Kur në vend zhvillohen apo drejtpërdrejtë transmetohen përmes televizionit ndeshje të rëndësishme ndërkombëtare, orari i ndeshjeve mund të ndryshojë gjegjësisht të rregullohet, ashtu që lojtarëve, klubeve, publikut etj. t'ju mundësohet përcjellja e këtyre ndeshjeve.

### **Neni 23**

Organizimin e ndeshjeve, e bënë klubi nikoqir. Klubi nikoqir nënkupton; klubi i parë i theksuar në orarin e ndeshjeve.

### **Neni 24**

**Klubi nikoqir është i obliguar:**

- Që për secilën ndeshje me shkrim ta paralajmërojë, apo të ketë kontratë të nënshkruar me organin për siguri publike (Policinë e Kosovës), më së voni 3 ditë para zhvillimit të ndeshjes dhe të kërkojë numër të nevojshëm të pjesëtarëve të sigurimit.

- Të ketë lejen e organit të sigurisë publike, Policisë së Kosovës, (në raste të veçanta edhe nga KFOR-it, apo Forca e Sigurisë së Kosovës), për organizimin e ndeshjes apo vërtetimin mbi pranimin e paraqitjes me shkrim, klubi nikoqir ia dorëzon delegatit të ndeshjes para fillimit të saj, e kjo së bashku me Protokol i përcillet Federatës gjegjësisht Komisionit Organizativ të Garave.
- Të caktojë përfaqësuesin zyrtarë për Siguri, që medoemos duhet të jetë anëtar i Kryesisë së klubit, dhe i cili duhet të kujdeset për sigurinë gjatë ndeshjes dhe pas saj.
- Emrin e përfaqësuesit zyrtarë dhe përfaqësuesit zyrtarë për siguri, me autorizim, klubi nikoqir ia dorëzon delegatit të ndeshjes, i cili i bashkëngjitet raportit të vet plotësues i cili i dërgohet Komisionit Organizativ të Garave.
- Përfaqësuesi zyrtarë është përgjegjës për organizimin e përgjithshëm të ndeshjes si dhe plotësimin, gjegjësisht mundësimin e kushteve për kryerjen e detyrës, delegatit të ndeshjes. - Zyrtari përgjegjës për siguri duhet të bënë sigurimin e gjyqtarëve, delegatit, mysafirëve, klubit të vet dhe organeve tjera zyrtare, para, gjatë dhe pas ndeshjes.
- Që gjatë kohës së ndeshjes ta siguroj automjetin e ndihmës së parë (obligative për ekipet e Superligës dhe Ligës së Parë) apo ndonjë automjet tjetër i dedikuar për ndihmë të shpejtë.
- Që gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes tek shikuesit, të ndalojë shitjen e pijeve alkoolike si dhe pijeve tjera joalkoolike me ambalazhe qelqi, plastike apo metali.
- Të bëjë regjistrimin e tabelave të automjetit kujdestar, me emër dhe mbiemër të mjekut, e kjo ti dorëzohet vëzhguesit të ndeshjes.
- Që në prezencën e delegatit apo gjyqtarit (në rast të mungesës së delegatit) dhe përfaqësueseve zyrtarë të klubeve, të përpiloj Protokolin e ndeshjes, më së voni 15 minuta para fillimit të ndeshjes. Protokoli përpilohet në 4 ekzemplar.
- Pas përfundimit të ndeshjes gjegjësisht protokolit, protokoli origjinal i dorëzohet delegatit të ndeshjes, ekzemplari i dytë nikoqirit, ndërsa ekzemplari i tretë klubit mysafir.

#### **Ekzemplari i katërt shërben për gazetarët të cilët e përcjellin ndeshjen:**

- a) Protokoli, në mënyrë obligative shtypet me kompjuter ose makinë shkrimi.
  - b) Mospërfillja e kësaj (mbushja e protokolit me stilo-laps) për skuadrat e Superligës dhe të Ligës së parë pason me ndëshkimet në vijim; Superliga me 200 euro, Liga e parë me 150 euro, dhe Liga e dytë me 100 euro.
- Të siguroj mbledhësit e topave (pionierë), ndërsa numri i tyre duhet të jetë maksimum 12, minimumi 6 veta me veshje sportive, të cilat dallohen nga ato të lojtarëve të cilët luajnë në fushë.
  - Të mos lejoj që në lokalet zyrtare të futen persona të cilët nuk kanë të drejtë.

**Të siguroj 3 - 7 topa për lojë, të përshtatshëm dhe kualitativ (nga një top prapa portave të lojës nga dy topa afër vijave të autit dhe një top me të cilin luhet):**

- a) Superliga; ..... 5 – 7 topa
  - b) Liga e parë; ..... 5 – 7 topa
  - c) Liga e dytë; ..... 3 – 5 topa
  - d) Liga e trete dhe kategoritë e reja; 3 – 5 topa.
- Përfaqësuesve zyrtarë, trajnerëve, mjekut, fizioterapeutit, t'iu siguroj emblemat (shenjat) që do ti bartin gjatë ndeshjes.
  - Klubi nikoqir është i obliguar që të sigurojë, semaforin e dorës (për paralajmërimin e ndërrimit – zëvendësimeve të lojtarëve).
  - Në rast të paralajmërimin për ardhje të organizuar të simpatizuesve mysafir, klubi nikoqir obligohet në sigurimin e hapësirës së caktuar për përcjelljen e ndeshjes nga ana e tyre.
  - Për prishjen e rendit, para gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes nga hapësira në të cilën janë të vendosur simpatizuesit e ekipit mysafir, përgjegjës dhe bartës i masave disiplinore sipas Rregullores Disiplinore të FFK-së do të jetë ekipi mysafir.
  - Klubi nikoqir obligohet që në hapësirën e paracaktuar të stadiumit të vendos flamurin shtetëror të Republikës së Kosovës, Flamurin e FFK-së, dhe ato të dy klubeve (nëse i kanë).
  - Ta siguroj përcjelljen pa pengesa të ndeshjes, klubit mysafir dhe organeve zyrtare.
  - T'i përfillë vendimet tjera, të cilat, në raste të veçanta, sipas nevojës, i merr Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.
  - Ekipi nikoqir është i obliguar ta bëjë sigurimin e fushës gjatë tërë kohës së zhvillimit të ndeshjes, përmes pranisë së pjesëtarëve të Policisë së Republikës së Kosovës.
  - Në raste të veçanta, sigurimin e ndeshjes mund ta bëjë edhe KFOR-i, Forca e Sigurisë së Kosovës. Asistencë në siguri mund të bëjë edhe sigurimi privat, por për këtë duhet të marr pëlqimin e Komisionit që udhëheq me garat.

**Në rastet kur ndeshja nuk zhvillohet për shkak se ekipi nikoqir nuk ka siguruar praninë e pjesëtarëve të forcave të apostrofuara në paragrafet paraprake, atëherë:**

- Komisioni Organizativ i Garave i rangut përkatës, do të caktojë terminin tjetër për zhvillimin e kësaj ndeshjeje të pafilluar, në pajtim me dispozitat e akteve normative të FFK-së, ndërsa të gjitha shpenzimet e përsëritura për personat zyrtarë si dhe shpenzimet e ekipit mysafir (udhëtimi dhe një racion shujtë), i bartë ekipi nikoqir.

- Nëse kjo ndeshje nuk zhvillohet as në terminin e përsëritur, caktuar nga Komisioni Organizativ i Garave për arsye të njëjtë, atëherë ekipi nikoqir – organizatori i ndeshjes, të njëjtën e humb me rezultatin zyrtarë, Parforfe (3:0).

### **Neni 25**

**Në të gjitha ndeshjet e futbollit, brenda rrethojës së fushës, në vendet përkatëse, mund të gjenden personat me sa vijon:**

- Kryetrajneri për Superligë, duhet të ketë së paku Licencën; profi dhe A të UEFA-s, ndërsa për ligën e parë së paku licencën B- UEFA, (deri në vendimin tjetër të KE të FFK-së), në të kundërtën Trajneri i pa licencuar largohet nga bankina ndërsa klubi dënohet me 500 euro.
- Kryetrajneri në Ligën e dytë, tretë dhe kategoritë e reja duhet të ketë së paku Licencën; C (deri në vendimin tjetër të FFK-se) në të kundërtën trajneri i pa licencuar largohet nga bankina ndërsa klubi dënohet me 200 euro, e njëjta vlen edhe për Juniorët dhe Kadetët dhe grup moshat e reja. Në rast të largimit të kryetrajnerit nga ana e klubit në Superligë, dhe Ligën e parë vendet e tyre në udhëheqjen e ekipeve nga trajnerët me kategori jo adekuate lejohen vetëm për dy xhiro të zhvilluara në vijim.

## **VI. HAPËSIRA TEKNIKE (Banka Rezervë)**

### **Neni 26**

Në hapësirën teknike gjatë zhvillimit të ndeshjes mund të qëndrojnë:

- Përfaqesuesi zyrtarë i klubit, me emblemën-shenjën përkatëse,
- lojtarët rezervë me pajisje sportive (gjithsej 12),
- kryetrajneri (shefi i shtabit teknik),
- trajneri i parë ndihmës,
- trajneri i dytë ndihmës,
- trajneri kondicional (atletikes),
- trajneri portierëve,
- mjeku me emblemën-shenjën përkatëse,
- fizioterapeuti me emblemën-shenjën përkatëse,
- Drejtori sportiv,
- Ekonomi

## **VII. HAPËSIRA RESTRIKTIVE (brenda rrethojave të fushës)**

### **Neni 27**

Në hapësirën restriktive të fushës së lojës (brenda rrethojave) mund të qëndrojnë;

- vëzhguesi i ndeshjes, me emblemën-shenjën përkatëse të FFK-së,
- fotoreporterët-gazetarët, me shenjat e mediave që iu përkasin,
- përfaqësuesi i rendit – komandanti i policisë,
- Zyrtari i klubit përgjegjës për siguri si dhe mbledhësit e topave.

### **Neni 28**

Në rast se dikush nga personat e lartpërmendur nga neni 26 dhe 27, nuk e ka përgatitjen përkatëse, emblemën-shenjën apo ID, delegati i ndeshjes do të kërkoj nga përfaqësuesi zyrtarë apo përgjegjësi për siguri i Klubit nikoqir, që personat e tillë të largohen nga fusha.

Në rast se kërkesa e delegatit nuk përfilllet, ndeshja nuk mund të fillojë, apo nëse ka filluar nuk mund të vazhdojë.

## **VIII. PARAQITJA E PARË DHE IDENTITETI I LOJTARËVE**

### **Neni 29**

Të gjithë lojtarët që paraqiten në ndeshje, duhet të kenë në rregull ID kartelat e garave për ndeshje. ID kartelat janë dëshmi e qartë se është bërë kontrollimi mjekësor, është paguar anëtarësia si dhe është bërë licencimi i lojtarit.

Kontrollimin mjekësor, lojtarët e bëjnë dy herë në vit - para fillimit të stinorit vjeshtor gjegjësisht stinorit pranveror, te mjeku specialist i medicinës sportive, i cili aftësinë e lojtarit e konstaton përmes listave të vërtetuara me numër të protokollit nga ky institucion sportiv e që e njëjta i dërgohet edhe Federatës së Futbollit të Kosovës.

Ne çoftë së lojtari paraqitet në ndeshje (lojë) i pa licencuar – pa ID kartelë, dhe pa kontrollim mjekësor ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtarë (3:0) në të mirë të ekipit kundërshtar (nëse për këtë klubit i mungojnë arsyet), kurse ndaj lojtarit dhe klubit do të ngritët procedura disiplinore.

Lojtari më i ri se 17 vjet, për tu paraqitur në ekipin e seniorëve duhet në mënyrë obligative t'i nënshtrohet kontrollimit special mjekësor, të cilit i lëshohet vërtetim nga Mjekësia sportive ndërsa verifikohet (dhe vuloset) në FFK.

Nëse konstatohet se nuk është përmbushur kjo dispozitë, ekipi që aktivizon lojtarë të këtillë ndeshjen e humb me rezultat zyrtarë (3:0), ndërsa ndaj lojtarit dhe ndaj klubit, pas inicimit të procedurës disiplinore (nga ana e Komisionit Organizativ të Garave) do të shqiptohet masa e paraparë me Rregulloren Disiplinore.

### **Neni 30**

Ne ekipin e seniorëve mund të inkuadrohen edhe lojtarët me të rinjë se 17 vjeçar por duhet të marrin lejen speciale të lëshuar nga Institucioni i Mjekësisë Sportive, të vërtetohet në FFK-ja, që të lejohet angazhimi i këtyre lojtarëve.

Lojtari i cili nuk ka mbushur moshën 16 vjeç nuk lejohet të luaj me ekipin e seniorëve të asnjë klubi pjesëmarrës në kampionatet ose garat e organizuara nga FFK .

### **Neni 31**

#### **E drejta e lojës sipas grup moshave:**

1. Në ekipin; U-19 (mosha 17 – 19 vjeç) të drejtë paraqitje në edicionin 2023- 2024 kanë lojtarët e lindur me 01.01.2005 e më të rinjë. Më të rinjë se 17 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar dhe lëshuar nga Mjekësia sportive dhe FFK-ja.
2. Në ekipin; U-17 (mosha; 15 - 17 vjeç) të drejtë paraqitje në edicionin 2023-2024 kanë lojtarët e lindur më; 01.01.2007 e më të rinjë. Më të rinjë se 15 vjeç mund të paraqiten me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar dhe lëshuar nga Mjekësia sportive dhe FFK-ja.
3. Në ekipin; U-15 (mosha; 13-15 vjeç) të drejtë paraqitje në edicionin; 2023-2024 kanë lojtarët e lindur me; 01.01.2009 e më të rinjë. Më të rinjë se 13 vjeç mund të paraqiten me kontrollim special mjekësor i cili lëshohet dhe vërtetohet nga Mjekësia sportive dhe FFK-ja.
4. Në ekipin; U-13 (mosha; 11-13 vjeç) të drejtë paraqitje në edicionin 2023-2024 kanë lojtarët e lindur me 01.01.2011 e më të rinjë. Më të rinjë se 11 vjeç mund të paraqiten me kontrollim special mjekësor i cili lëshohet dhe vërtetohet nga Mjekësia sportive dhe FFK-ja.
5. Në ekipin; U-11 (mosha; 09-11 vjeç) të drejtë paraqitje në edicionin 2023-2024 kanë lojtarët e lindur më; 01.01.2013 e më të rinjë. Më të rinjë se 09 vjeç mund të paraqiten me kontrollim special mjekësor i cili lëshohet dhe vërtetohet nga Mjekësia sportive dhe FFK-ja.
6. Në ekipin; U-09 (mosha; 7-9 vjeç) të drejtë paraqitje në edicionin 2023-2024 kanë lojtarët e lindur me 01.01.2015 e më të rinjë. Më të rinjë se 7 vjeç mund të paraqiten me kontrollim special mjekësor i cili lëshohet dhe vërtetohet nga Mjekësia sportive dhe FFK-ja.

### **Neni 32**

Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtarët të cilët janë të evidentuar-licencuar në FFK.

Një ekip gjatë një edicioni – stinori garues mundet të licencojë më së shumti; 35 lojtarë Identifikimin e lojtarëve e bënë delegati i ndeshjes, në mungesë të tij, këtë detyrë e kryen, sipas Rregullores, gjyqtari kryesor i ndeshjes dhe atë para fillimit, gjatë dhe pas ndeshjes.

Përfaqësuesit e ekipeve kanë të drejtë të vërtetojnë identitetin e lojtarëve të ekipit tjetër dhe atë para fillimit të ndeshjes. Për identifikimin e lojtarëve shërben ID kartela e lëshuar nga Federata e Futbollit e Kosovës.



Në qoftë se lojtari nuk posedon ID kartelë identifikimi i tij bëhet në bazë të dokumentit publik (leja personale-pasaporta), e në rast të mungesës së tyre, bëhet fotografimi i lojtarit me delegatin.

Fotografinë e siguron ai ekip, i cili në radhët e veta ka futbollistë pa ID kartelë.

Klubi është i obliguar që brenda 24 orëve, ID kartelën t'ia prezantoj Komisionit Organizativ të Garave.

### **Neni 33**

Identiteti i lojtarit dhe rezervistit të cilët janë shënuar në protokol, e nuk kanë mbërritur deri në fillim të ndeshjes, do të vërtetohet gjatë pushimit në mes pjesëve të ndeshjes apo menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, para përpilimit të Procesverbalit – protokollit të ndeshjes.

Përfaqësuesit zyrtarë të klubeve, e kanë obligim që 60 minuta, para fillimit të ndeshjes, delegatit të ndeshjes apo gjyqtarit kryesor (nëse mungon-delegati), t'ia dorëzojnë ID kartelat e lojtarëve.

Klubi nikoqir është i obliguar të siguroj ekzemplar të mjaftueshëm të protokollit si dhe kompjuterin apo makinën e shkrimit, sipas Rregullave të këtyre Propozicioneve.

## **IX. DELEGATËT**

### **Neni 34**

Listën e delegatëve, për çdo rang të garave veç e veç, me propozimin e komisionit përkatës, e shqyrton dhe e aprovon Komiteti Ekzekutiv i FFK-së. Sipas nevojës delegati nga lista e rangut më të lartë mund të angazhohet në ndeshjet e rangut më të ulët.

Sipas vlerësimit të vetë dhe nevojës, “Super vëzhguesit“ e ndeshjes i cakton Kryetari i FFK-së.

### **Neni 35**

Delegati është i obliguar t'ij njoh Propozicionet e Garave si dhe aktet tjera normative të FFK-së.

### **Neni 36**

Delegatët janë të obliguar të marrin pjesë në seminare të dedikuara për delegat, të cilat i organizon FFK-ja, në të kundërtën, ata nuk mund të gjenden në listën e delegatëve.

### **Neni 37**

Delegati është i obliguar, që në rast të ndërprerjes së ndeshjes, përjashtimit të lojtarëve, mosmarrëveshjeve eventuale në mes të klubeve të paraqitura lidhur me garat e raste të tjera të ngjashme diskutabile, të përshkruaj detajisht dhe me korrektësi të gjitha momentet e nevojshme të cilat janë të domosdoshme për marrjen e vendimit nga organi përkatës.

### **Neni 38**

Delegati është i obliguar që në Protokol të ndeshjes, pas vërejtjes së gjendjes, të konstatojë plotësimin e kushteve të parapara për zhvillimin e ndeshjes të cilat janë të rregulluara me këto Propozicione dhe akte tjera normative të FFK-së.

### **Neni 39**

Delegati në ndeshje, si përfaqësues zyrtarë i Federatës, përfaqëson Komisionin Organizativ të Garave dhe bënë mbikëqyrjen e zhvillimit të ndeshjes.

Delegati, gjatë kohës së ndeshjes dhe kryerjes së detyrës, bartë emblemën-shenjën e FFK-së, të cilën ia siguron Federatën.

Delegati është i obliguar të përcjell, vlerësoj dhe të përshkruaj objektivisht të gjitha kushtet dhe përfilljen e rregullave të këtyre Propozicioneve. Ai kryen mbikëqyrjen e organizimit të ndeshjes dhe u mundëson ndihmë të plotë klubeve dhe gjyqtarëve.

#### **Detyrat konkrete të delegatit janë:**

- të paraqitet në fushë më së paku 90 minuta para fillimit të ndeshjes së caktuar,
- deri në kohën e caktuar për fillimin e ndeshjes, të konstatojë identitetin e lojtarëve dhe rregullsinë e librezave sportive të futbollit,
- përfaqësuesve të klubeve t'u mundësoj shqimin e librezave sportive të lojtarëve të klubit rival,
- kujdesët që Protokoli i ndeshjes të përpilohet në rregull, dukshëm dhe lexueshëm,
- të ndalojë hyrjen në pjesën e caktuar të fushës, të gjithë atyre që për këtë nuk kanë të drejtë, si dhe personave zyrtarë të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga këto Propozicione, që librezat sportive të futbollit dhe protokolin e ndeshjes, t'i mban me vete deri në përfundimin e ndeshjes, për arsye të përcjelljes dhe kontrollimit më të mirë të ndeshjes,
- Menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, në protokol ta bëjë vlerësimin-notimin e gjyqtarëve të ndeshjes (nëse nuk ka vëzhgues të referimit), në bazë të udhëzimeve të cilat i ka paraparë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së,
- të kontrollojë organizimin e ndeshjes,
- që pas përfundimit të ndeshjes, në prani të përfaqësuesve zyrtarë të klubeve dhe gjyqtarëve, të përpilojë protokolin e ndeshjes së zhvilluar dhe që eventualisht të merre në bashkëbisedim personat e nevojshëm, njëkohësisht t'i mbaj librezat sportive të lojtarëve të përjashtuar, të merr deklaratat e të dënuarave dhe këtë ta konstatojë në protokolin e ndeshjes,
- gjyqtari dhe gjyqtarët ndihmës, përfaqësuesit zyrtarë të të dy klubeve si dhe lojtarët e përjashtuar apo trajneri (dhe personat e përjashtuar nga bankina) janë të obliguar që me kërkesën e delegatit të ndeshjes, të japin deklaratat, përgjigje të sakta dhe precize, të cilat shënohen në protokolin e ndeshjes,
- delegati ka autorizime të mëdha ndaj përfaqësuesit zyrtarë, njëkohësisht edhe shërbimit të rendit për siguri publike,
- delegati nuk ka të drejtë të përzihet në vendimet e gjyqtarit,
- delegati nuk ka të drejtë të ndalojë pjesëmarrjen e ndonjë lojtari në lojë, por mund t'i sugjerojë klubit për pasojat eventuale për pjesëmarrjen e atij lojtari, në bazë të Rregulloreve në fuqi të FFK-së,
- delegati nuk ka autorizime të jap kurrfarë deklarate publike lidhur me ndeshjen,
- delegati është i obliguar që raportin e vet plotësues, protokolin e ndeshjes, si dhe komplet dokumentacionin përcjellës të ndeshjes ta dërgoj në afat prej 24 orë, në shërbimin administrativ të Federatës (Komisionit Organizativ të Garave),

- aty ku është e obligueshme delegatët e ndeshjeve raportet e tyre i bëjnë në bazë të platformës digjitale FIFA Konekt,
- krahas protokollit të ndeshjes dhe raportit plotësues delegati ndeshjës duhet ta përcjellë edhe formularin për vlerësimin e FAIR-PLAY nga ndeshja e zhvilluar.
- Në rast të mungesës së delegatit, detyrën e tij e kryen gjyqtari kryesor i ndeshjes.

#### **Neni 40**

Komisioni Organizativ i Garave, ka të drejtë dhe është i obliguar të ndërmarr masa për ndalimin e kryerjes së detyrës së delegatit, atyre delegatëve të cilët nuk i kryejnë detyrat e veta në pajtim me këto Propozicione. Masat e ndërmarra, shpallen në Faqen zyrtare të FFK-se, dhe "buletinin zyrtarë" të FFK-së.

#### **Neni 41**

Komisioni Organizativ i Garave, mund të japë udhëzime të veçanta, për kryerjen e detyrës së delegatit të ndeshjes.

### **X. GJYQTARËT**

#### **Neni 42**

Listën e gjyqtarëve, për çdo rang të garave veç e veç, e propozon Komisioni për gjyqtarë i FFK-së, i caktuar nga ana e KE të FFK-së, ndërsa e verifikon dhe aprovon Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

#### **Neni 43**

Gjyqtarët i cakton komisioni për delegimin e gjyqtarëve, në bashkëpunim me përgjegjësin e atij rangu të garave. Komisionin për delegimin e gjyqtarëve e zgjedh Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

#### **Neni 44**

Inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve të cilët nuk i aplikojnë me përpikëri Rregullat e lojës së futbollit apo ato i aplikojnë gabimisht, e bënë Komisioni Organizativ i Garave i rangut gjegjës, dhe atë tek Komisioni Disiplinor dhe të Etikës i shkallës së parë të FFK-së.

#### **Neni 45**

Ndeshjet kampionale ose të Kupës si dhe të gjitha ndeshjet publike, i referon vetëm gjyqtari i kualifikuar për rangun përkatës.

#### **Neni 46**

Gjyqtari është i obliguar që në bazë të Rregullave të lojës së futbollit, para fillimit të ndeshjes të shikoj fushën dhe njëheri do të vendosë se a është ajo e përshtatshme për lojë apo jo.

Në rast se gjyqtari konstaton, në praninë e kapitenëve të të dy ekipeve, se në kohën e caktuar për fillimin e ndeshjes fusha nuk është e përshtatshme për lojë, ndeshja nuk mund të zhvillohet.

Vendimin lidhur me të, ja përcjellë vëzhguesit të ndeshjes, ndërsa klubet janë të obliguara të veprojnë sipas dispozitave të këtyre Propozicioneve.

Gjendja faktike nga vendi i ngjarjes konstatohet në Protokolin e ndeshjes dhe nënshkruhet nga të gjithë personat e autorizuar, e cila në afatin prej 24 orëve i dorëzohet Komisionit Organizativ të Garave të rangut gjegjës.

#### **Neni 47**

Nëse gjyqtari kryesor i ndeshjes nuk paraqitet në fushë në kohën e paraparë, ndeshjen do ta udhëheq gjyqtari i katërt (nëse është i caktuar) ose gjyqtari i parë ndihmës. Në rast se edhe gjyqtari i parë ndihmës nuk paraqitet, atëherë ndeshjen do ta referoj gjyqtari i dytë ndihmës. Në rast se në ndeshjen e caktuar nuk paraqitet treshi i gjyqtarëve të deleguar, delegati i ndeshjes, pas konsultimit me përfaqësuesit zyrtarë të klubeve do të merr vendim që ndeshjen ta referoj njëri nga gjyqtarët (e sprovuar) të pranishëm në stadium.

Nëse, në mes të klubeve nuk arrihet marrëveshja, në atë rast vendos delegati i ndeshjes, dhe këtë e konstaton në protokolin e ndeshjes.

Për këtë përpilohet procesi me shkrim, të cilën e nënshkruajnë kapitenët e ekipeve si dhe përfaqësuesit zyrtarë ( të autorizuar) të klubeve. Nëse mungojnë edhe gjyqtarët edhe delegati atëherë ndeshja nuk mund të zhvillohet.

#### **Neni 48**

Gjyqtarët janë të obliguar që në protokolin e ndeshjes, të ushtrojnë fletëparaqitje kundër lojtarëve, zyrtarëve si dhe organeve tjera prezentë në ndeshje, lidhur me kundërvajtjet e shkaktuara para, gjatë dhe pas ndeshjes, e që vëzhguesi i ndeshjes në bazë të fletëparaqitjes së gjyqtarit, bënë hapjen e procedurës (marrjen e deklaratave si dhe punëve tjera që i përkasin vëzhguesit të ndeshjes).

Lojtaret dhe personat e larguar (ndëshkuar) prej gjyqtarit obligohen të largohen menjëherë nga fusha, dhe duhet të shkojnë ne vendin e posaçëm ose ne tribune.

Nëse veprojnë ndryshe bëjnë kundërvajtje disiplinore dhe ndëshkohen sipas Rregullores Disiplinore.

### **XI. NDALESA E ZHVILLIMIT TË NDESHJEVE NË FUSHËN E CAKTUAR APO FUSHAT E CAKTUARA TË RAJONIT**

#### **Neni 49**

Nëse klubi është i dënuar me dënimin për moszhvillimit të ndeshjeve në fushën e caktuar, ai është i obliguar që më së voni 7 ditë para zhvillimit të ndeshjes ta njoftojë Komisionin Organizativ të Garave se në cilën fushë do ta zhvillojë ndeshjen.

Në çiftë se fusha është e regjistruar për këtë rang të garave, Komisioni Organizativ i Garave do të lejoj zhvillimin e ndeshjes, e nëse nuk është ai rast, Komisioni Organizativ i Garave do të kërkojë prej komisionit për inspektimin e fushave të bëjë kontrollimin-shqimin e fushës. Shpenzimet e komisionit për praninë të fushës i bartë parashtruesi i kërkesës.

Ekipi mysafir duhet të jetë i lajmëruar 48 orë, para orës së përcaktuar për fillimin e ndeshjes, për vendin e zhvillimit të ndeshjes. Fusha për zhvillimin e ndeshjes, duhet të jetë në largësi më së paku prej 30 km. (rrugë e asfaltuar) nga stadiumi i klubit të dënuar.

### **Neni 50**

Komisioni për pranimin dhe shqimin e fushave, duhet të ketë njohuri me Propozicionet e kësaj lëmie. Ky Komision është në përbërje prej 3 anëtarëve (një të jetë gjyqtar apo ish gjyqtar), dhe gjatë një edicioni të garave (viti garues) kontrollimin e bënë më së paku dy herë, e nëse vlerësohet si e nevojshme, në vende të caktuara, edhe më shpesh.

## **XII. KUNDËRVAJTJET DISIPLINORE**

### **Masat disiplinore dhe direktivat**

#### **Neni 51**

1. Në rast të sjelljes jo sportive, shkeljes së Statutit, rregulloreve dhe vendimeve të FFK-së, trupat juridike të FFK-së kanë autorizim të aplikojnë masat disiplinore dhe vendimet në harmoni me këtë Statut dhe Rregulloret Disiplinore.
2. Lejohet aplikimi i më shumë masave disiplinore, po ashtu i më shumë vendimeve, rreth një çështjeje (lënde) të caktuar.
3. Mund të merret vendim dhe shtesë tjetër masës disiplinore. Ajo definon si do të ekzekutohet masa disiplinore ose si të funksionojë pala e lidhur me lëndën.

### **Masat disiplinore kundër anëtarëve dhe klubeve**

#### **Neni 52**

Kundër anëtarëve, klubeve apo personave tjerë juridik mund të aplikohen masat disiplinore poshtë shënuar.

1. **Në lidhje me anëtarët:**
  - a) Paralajmërim (vërejtje),
  - b) vërejtje e rëndë,

- c) gjobë (dënimi në të holla),
- d) anulimi rezultativ të ndeshjes,
- e) urdhër për zhvillimin e serishëm të ndeshjes,
- f) zbritja e pikëve,
- g) regjistrimi i ndeshjes në favor të një klubi,
- h) zhvillimi i ndeshjes pa spektator,
- i) zhvillimi i ndeshjes në territor neutral,
- j) dënimi i stadiumit,
- k) ndalimi i prodhimit të sinjalit televiziv për një ose më shumë ndeshje dhe /ose që sinjali televiziv për një ose më shumë ndeshje të jetë pa pagesë,
- l) diskualifikim nga ndeshjet në vijim dhe/ose përjashtim nga kampionati i ardhshëm,
- m) largim,
- n) dërgimi në rang më të ulët,
- o) ndalimi i transferit,

## 2. Në lidhje me personat privat (individë):

- a) Paralajmërim (vërejtje),
- b) vërejtje e rëndë,
- c) gjobë,
- d) largim,
- e) suspendim për një numër të caktuar ndeshjesh ose periudhë të caktuar,
- f) ndalim prezence në zhveshtore apo bankën e "rezervistëve",
- g) ndalesa e marrjes pjesë në çdo aktivitet të lidhur me futbollin.

## 3. Shqiptimi i masave të tjera juridike

Krahas dënimit për kundërvajtje sipas Rregullores Disiplinore të FFK-së, personave fizikë dhe juridikë që kanë kryer vepra penale në ngjarjet sportive u shqiptohen edhe masa të tjera të parapara me Kodin Penal të Kosovës.

### Neni 53

Me procedurë disiplinore vendos Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i FFK-së, unik për të gjitha rangjet, si organ i shkallës së Parë, i rangut përkatës për: lojtarë, klube, trajnerë, gjyqtarë dhe persona zyrtarë. Komisioni Disiplinor i Lidhjeve Rajonale, do të trajtoj kundërvajtjet e kryera në garat e Lidhjes Rajonale dhe është Komisioni i shkallës së parë.

Komisioni për Ankesa i FFK-së, vendos mbi të gjitha ankesat disiplinore dhe garuese.  
Komisioni për Ankesa është unik për të gjitha rangjet e garave dhe garave në Lidhjet rajonale.

#### **Neni 54**

Mbrojtjen e Rregullores Disiplinore dhe Akteve tjera normative të FFK-së, e bënë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, sipas kërkesës së parashtruar. Vendimi i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, është definitiv.

### **XIII. PROCEDURA DISIPLINORE**

#### **Neni 55**

Komisioni Organizativ i Garave si organ i shkallës së parë, është i obliguar që në afat prej 3 ditësh, e në raste kur kërkohet zgjidhje urgjente edhe më shkurt (nga dita e marrjes së ankesës), ta shqyrtojë ankesën.

#### **Neni 56**

Lojtari i ndëshkuar me 4 (katër) kartonë të verdhë pushon automatikisht në gjiron e radhës. Dënimi për shkak të 4 vërejtjeve publike (kartonët e verdhë) të shqiptuara në ndeshje kampionale nuk mund të ekzekutohet në ndeshjen për Kupë dhe anasjelltas. Ky rregull vlen për të gjitha kategoritë.

Vuajtja e dënimit bartet edhe në kampionatin vijues të garave nëse bëhet fjalë për kartonin e kuq apo të kuqin pas dy të verdhëve, si dhe bartet edhe dënimi i marrë në ndeshjen e fundit (kartoni i 4 i verdhë me radhë) në ndeshjen e parë kampionale vijuese.

Kartonët e tjerë të verdhë shlyhen dhe nuk barten në kampionatin vijues.

Dënimi automatik për shkak të dy vërejtjeve publike (kartonëve të verdhë) në ndeshjet për Kupën e Kosovës, do të ekzekutohet në ndeshjen e parë të radhës për Kupën e Kosovës, mirëpo nëse lojtari i cili ka një karton të verdhë në ndeshjet paraprake të Kupës dhe në ndeshjen e dytë gjysmë finale, ndëshkohet me karton të verdhë, i lejohet zhvillimi i ndeshjes finale të Kupës së Republikës së Kosovës.

Lojtari i cili gjatë një ndeshjeje ndëshkohet me kartonin e dytë të verdhë, automatikisht ndëshkohet me të kuqin, dhe pushon xhiron e radhës (edhe xhiron e parë të kampionatit të ardhshëm). Ky dënim nuk mund të ekzekutohet në garat për Kupë.

Lojtari i ndëshkuar me katër karton të verdhë te Juniorët, pushon automatikisht në xhiron e radhës te Juniorët, në qoftëse lojtari Junior ndëshkohet me katër kartonat e verdhë te Seniorët pushon automatikisht në ndeshjen e radhës te Seniorët.

Lojtari i cili ndëshkohet direkt me karton të kuq detyrimisht pushon xhiron e radhës qoftë për gara të rregullta, qoftë për garat e KUPËS.

Lojtari i cili ka marrë kartonin e kuq në ndeshjet e Juniorëve nuk mund të paraqitet në ndeshjet e ekipit Senior pa e vuajtur dënimin në ekipin e Juniorëve.

#### **Neni 57**

Secili klub është i obliguar që të udhëheq evidencën e vërejtjeve publike të lojtarëve të vet. Shërbimi administrativ i Federatës, në bashkëpunim me Komisionin Organizativ të Garave udhëheqë evidencën mbi vërejtjet publike, bënë regjistrimet dhe ato i shpallë në “Buletinin zyrtarë” të FFK-së.

Mos shpallja në buletin zyrtarë, nuk e liron klubin nga obligimi për të ekzekutuar dënimin e shqiptuar nga komisioni përkatës.

#### **Neni 58**

Nëse vërtetohet se Klubi mikpritës i cili e zhvillon ndeshjen në fushë të vetë apo në fushën e kontraktuar, nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për t’i penguar incidentet, para, gjatë dhe pas ndeshjes do të dënohet në bazë të Rregullorës Disiplinore të FFK-së. E njëjta do të ndodhë edhe me Klubin mysafir, simpatizuesit e të cilëve kanë iniciuar apo kanë marrë pjesë në incident.

#### **Neni 59**

Nëse ndeshja ndërprehet për shkak të sulmit fizik ndaj gjyqtarëve, lojtarëve apo personave zyrtar, e njëjta do të regjistrohet me rezultat zyrtarë 3:0, kurse ndaj ekipit dhe shkaktarit të incidentit, do të iniciohet procedura disiplinore.

Nëse përjashtohet përfaqesuesi zyrtar, atë mund ta zëvendësojë drejtori sportiv ose kryetrajneri.

Nëse shkaktari i ndërprerjes nuk është asnjëri ekip apo shikuesit, por të njëjtën e ndërprejnë gjyqtari pa ndonjë arsye të madhe, (e kjo dëshmohet pas verifikimit të gjithanshëm), **ndeshja do të përsëritet, duke filluar nga ajo minutë në të cilën ka ardhur deri të ndërprerja e ndeshjes.**

**Golat e shënuar në ndeshjen e ndërprerë janë të vlefshëm, sikur edhe kartonët e kuq dhe kartonët e verdhë.**

Kundër gjyqtarit për të cilin konstatohet se ka referuar njëanshëm (ka marrë vendime të njëanshme), iniciohet procedura disiplinore.



## **Neni 60**

Në qoftë se ekipi nuk paraqitet në ndeshje për shkaqe të pa arsyeshme, ndeshjen e humb me rezultat zyrtarë 3:0 dhe mund të dënohet me marrjen (minus pikëve) prej 3 e deri 9 pikëve nga pikat e përgjithshme të fituara, apo të 9 pikëve negative.

Në qoftë se një ekip pa arsye nuk paraqitet në (2) dy ndeshje (ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar) gjatë një kampionati (vjeshtor – pranveror), do të largohet nga garat e mëtejme.

Tek Juniorët, Kadetët dhe grup moshat e reja përjashtimi bëhet pas mungesës në 3 (tri) ndeshje pa arsye. Ekipi i cili xhirot e fundit nuk udhëton në ndeshje pa arsye mund të dënohet nga Komisioni Organizativ i Garave përkatëse me minus 3 (tri) deri minus; 6 (gjashtë) pikë për stinorin e ardhshëm garues.

## **XIV. REGJISTRIMI I NDESHJEVE TË KLUBIT TË SUSPENDUAR**

### **Neni 61**

Klubi i cili gjendet nën suspendim për shkak të moskryerjes së obligimeve të ndryshme, nuk mund të paraqitet në ndeshje, kurse ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtarë 3:0 në dobi të klubit kundërshtar, kurse ndaj klubit do të merren masa rigoroze në përputhje me dispozitat e Rregullores Disiplinore të FFK-së.

Edhe në rastet kur ndeshja zhvillohet, klubi që ndeshjen e zhvillon nën suspendim, do ta humb atë me rezultat zyrtarë 3:0 dhe ndaj tij do të iniciohet procedura disiplinore.

Nëse, të dy klubet luajnë nën suspendim ndeshja do të konsiderohet sikur të mos ishte zhvilluar fare dhe asnjëra prej ekipeve nuk merr pike. Ekipet do të përballen me procedurë disiplinore.

## **XV. ANKESAT**

### **Neni 62**

Ankesa lidhur me ndeshje paralajmërohet në protokolin e ndeshjes (lidhur më paraqitjen e lojtarëve, anëtarësisë, apo licencimit), apo jashtë tij, në afat prej 24 orësh.

Paralajmërimin e ankesës mund ta bëj edhe pala e tretë e interesuar për rezultatin e ndeshjes dhe atë në afat prej 24 orësh. Paralajmërimi i ankesës mund të bëhet në afatin e cekur më shkrim ose në mënyrë telegrafike, në adresë të Federatës.

Arsyetimin përkatës, duhet dorëzuar më së largu 48 orë pas përfundimit të ndeshjes, Komisionit Organizativ të Garave të rangut përkatës. Krahas ankesës duhet bashkangjitur fletëpagesën e taksës për ankesë në vlerë prej 100 euro.

Në qoftë se ankesa nuk është paralajmëruar në protokolimin e ndeshjes ose në afat prej 24 orësh pas përfundimit të ndeshjes, apo nuk është kompletuar material i duhur (jo komplet), apo nuk është taksuar, nuk do të shqyrtohet fare.

### **Neni 63**

Për secilën ankesë në shkallën e parë, duhet të vendosët në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të ankesës, përveç nëse ankesa është e motivuar nga rastet që kërkojnë zgjidhje urgjente. Komisioni Organizativ i Garave, ato ankesa, është i obliguar që t'i shqyrtoj në afat prej tri (3) ditësh nga dita e marrjes së ankesës.

Ankesa nga Komisioni përkatës për ankesa, duhet të jetë e shqyrtuar në afat prej 8-të ditëve nga dita e paraqitjes së ankesës me dëshmi të pagesës. Të gjitha ankesat duhet shqyrtuar deri në para zhvillimin e ndeshjes së fundit të kampionatit gjegjësisht atij stinori të garave.

Nëse edhe në afat prej 8 ditësh, nuk zgjidhet ankesa, pala e cila ka parashtruar ankesë, duhet ta konsideron se ankesa i është refuzuar dhe mund të parashtrroj kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, pas 15 ditëve nga dita e protokolimit të ankesës në Komisionin për Ankesa.

Afati për ushtrimin e kërkesës për mbrojtjen e rregullores është 15 ditë, (pra me se largu 30 dite nga protokolimit i ankesës për shkallën e II, në FFK në rastë se nuk ka Vendim të shkallës së II).

Kur xhirot zhvillohen ditën e diel dhe menjëherë të mërkurën, atëherë afati për kompletim të lëndës së ankesës dhe taksimit të saj është 24 orë nga përfundimi i ndeshjes së zhvilluar.

Nëse afati për ushtrimin e ankesës apo shqyrtim të saj skadon në ditën e diele ose në ditën e festës shtetërore, afati për ushtrimin e ankesës vazhdon edhe në ditën e parë të ardhshme të punës.

Organi që udhëheq me garat është i obliguar që të shqyrton lëndën apo ankesën e paraqitur para fillimit të xhiros së radhës qoftë ajo kampionale apo e kupës.

### **Neni 64**

Komisionet e FFK-së, janë të obliguar që vendimet e marra t'i publikojnë menjëherë në Ueb Faqen zyrtare të FFK-së, dhe të njëjtat t'ua dërgojnë klubeve me anë të Faksit apo e-mali-it zyrtarë të cilat ekipet i kanë dorëzuar para fillimit të Kampionatit.

### **Neni 65**

KE, duhet të merr vendim definitiv në afat prej 30 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të Komitetit Ekzekutiv i FFK-së, duhet të paraqitet në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit të Komisionit për ankesa ose në rastë të mos marrjes të Vendimit të shkallës të II, 30 dite nga dita e protokolimit të ankesës në shkallën e II (dytë).

Nuk do të shqyrtohet asnjë ankesë apo kërkesë e cila është paraqitur pas kalimit të afatit kohor për ankesë apo kërkesë, e njëjta konsiderohet si e refuzuar.

## **XVI. REGJISTRIMET E NDESHJEVE KAMPIONALE DHE KUPË**

### **Neni 66**

Të gjitha ndeshjet kampionale dhe për Kupë, i regjistron Komisioni Organizativ i Garave, në afat prej 3 ditësh nga dita e zhvillimit të ndeshjes.

Në qoftë se, në ndonjë ndeshje është ushtruar ankesa, atëherë afati për regjistrimin e ndeshjes do të shtyhet deri në marrjen e vendimit sipas ankesës, gjegjësisht deri në vendimin e plotfuqishëm lidhur me ankesën.

Ndeshja e regjistruar, nuk mund të anulohet nga i njëjti organ i garave përveç të rasteve decidive të parapara me rregulloren e garave të futbollit të FFK-së. Nëse xhirot zhvillohen të dielën dhe të mërkurën, afati për regjistrimin e ndeshjeve është dy ditë nga dita e zhvillimit të ndeshjes së fundit të asaj xhiroje e doemos para fillimit të xhiros së radhës qoftë ajo kampionale apo për kupë (përpos kur ka ankesa lidhur me regjistrimin e ndeshjes).

### **Neni 67**

Në çoftë se, një ekip me vetëdëshirë largohet nga garat e mëtutjeshme apo Komisioni Organizativ i Garave e largon për shkak të moszhvillimit të dy ndeshjeve, atëherë ai ekip do të fshihet nga garat e mëtutjeshme, kurse për ndeshjet e zhvilluara dhe ato që do të zhvillonte do të veprohet kësisoj:

- Nëse klubi tërhiqet ose përjashtohet nga garat pasi që të ketë zhvilluar gjysmën e ndeshjeve apo më pak, nga numri i përgjithshëm i ndeshjeve të parapara për tërë kampionatin, atëherë të gjitha ndeshjet e tij të zhvilluara anulohen.
- Nëse klubi tërhiqet apo përjashtohet nga garat pasi të ketë zhvilluar më tepër se gjysmën e numrit të përgjithshëm të ndeshjeve të parapara për atë kampionat, atëherë ndeshjet e tij të zhvilluara deri në atë moment do të regjistrohen me rezultate të arritura, ndërsa ndeshjet e mbetura deri në fund të kampionatit nuk do të zhvillohen dhe do të regjistrohen me rezultat zyrtarë (3:0) në favor të kundërshtarëve të tij të ardhshëm të paraparë me kalendar të garave.
- Ndeshje e zhvilluar në kuptim të këtij neni konsiderohet ndeshja e zhvilluar në fushë dhe e regjistruar me rezultat të arritur në fushë apo rezultat zyrtarë (në rast të ankesës së aprovuar).

## **XVI. VËRTETIMI I PLASMANIT DHE PERFAQESIMI NË GARA UEFA**

### **Neni 68**

Ekipi i cili e fiton ndeshjen në garat kampionale arkëton 3 pikë, kurse nga ndeshja rezultati i të cilës është i barabartë, secili klub arkëton nga një pikë. Për secilën garë të përhershme e cila zhvillohet sipas sistemit të pikëve, përpilohet (mbahet) tabela.

**Tabela përmban emrat e ekipeve, numrin e ndeshjeve të zhvilluara, rezultatet e arritura në këto ndeshje, numrin e pikëve të fituara dhe numrin e golave të shënuara respektivisht të pranuar (pësuara):**

- a. Plasmani i ekipeve në tabelë caktohet në bazë të pikëve të fituara dhe plasmanin më të mirë e siguron ekipi i cili ka fituar më shumë pikë,
- b. Nëse ekipet që kanë plasman të barabartë në tabelle, e garojnë për kreun e tabelës (titullin e kampionit), daljen në gara ndërkombëtare, largimin në rang me të ulët, garojnë për barazh (mbetje, hyrje në lige) do të merret për baze rezultati dhe golaverazhi në takimet e ndërsjellat,
- c. Nëse ekipet kanë plasman të barabartë edhe në takimet e ndërsjellat merren për baze golat e shënuar në kampionat, pra ekipi që ka shënuar me shume gola,
- d. Nëse ekipet kanë të barabarta edhe golat e shënuara gjate kampionatit, atëherë merren për bazë golat e shënuar si mysafir gjatë kampionatit garues.

**Nëse edhe në këtë në mënyrë nuk mund të vërtetohet plasmani atëherë zhvillohen ndeshje në mes të ekipeve të interesuara dhe atë:**

- e. Një ndeshje në fushën neutrale (nëse janë dy ekipe) që e cakton KE, e nëse pas 90 minutave, rezultati është i barabartë pasojnë shtyrja 2 x15 minutave e në rast rezultati të barabartë pasojnë penalltitë,
- f. Tri ndeshje me sistem të pikëve të njëfishta në terren neutral, nëse janë në kombinim 3 ekipe,
- g. Numër i nevojshëm i ndeshjeve në sistem të njëfishtë të pikëve, në terren neutral, nëse janë në kombinim 4 ose më tepër ekipe,
- h. Nëse ekipet e theksuara në paragrafet paraprake arrijnë marrëveshje ndërmjet veti, në vend të zhvillimit të këtyre ndeshjeve, çështjen e fituesit mund ta përcaktojnë edhe me short, të cilin do ta udhëheq organi kompetent i garave.

## **Neni 69**

**Përfaqësimi i Ekipeve në Garat Ndërkombëtare:**

- i. Ekipi i cili shpallet kampion në garat kampionale përfaqëson Kosovën në garat e UEFA-së (Liga e kampionëve),
- ii. Ekipi nën kampion apo edhe më poshtë i klasifikuar mund të merr pjesë në garat e UEFA-s nëse mundësohet kjo nga UEFA në bazë të koeficientit zyrtarë për pjesëmarrje.
- iii. Ekipi i cili shpallet fitues i Kupës së Kosovës, përfaqëson Kosovën në garat UEFA Euro ligë,
- iv. Nëse Ekipi fitues i KUPËS së Kosovës, për shkaqe të ndryshme nuk e përfaqëson Kosovën (nuk licencohet për garat e UEFA Euro ligës, atëherë zëvendësohet me ekipin e radhës (që nuk është pjesëmarrës i garave të UEFA-së) që ka plasmanin më të mirë respektiv në kampionatin e rregullt të Kosovës, e jo finalistin i KUPËS, me kusht që të jetë i licencuar paraprakisht për garat e UEFA-së.

## **XVIII. SISTEMI I KUPËS**

## Neni 70

Garat e KUPËS së Kosovës, zhvillohen në sistemin e tillë që së pari, me gara fillojnë ekipet e Ligës së tretë dhe Ligës së II-të, të cilat përmes eliminimit vijnë deri në 2 (dy) ekipet fituese të cilave më pastaj iu bashkëngjiten; 20 ekipeve të dy grupeve të Ligës së Parë dhe 10 ekipeve të SUPERLIGËS (gjithsej 32 ekipe) nga e 16-ta e finales.

Të rregullohet zhvillimi i garave të Kupës nga e 16-ta, e finales (nikoqir vendas). Ndashjet kanë sistem eliminimi - sistem i njëfishtë.

Ndashjet e Kupës nga e 16-ta e finales kanë short gjysmë të dirigjuar.

### **Pjesëmarrëse 32 ekipe të ndara në dy vazo:**

- a) Në vazon e parë do të futen 16 ekipe dhe ato janë: **10 ekipet e Superligës, 3 ekipe të Ligës së Parë Grupi A të cilat janë të renditura nga vendi i parë, i dytë dhe i tretë, dhe 3 ekipe të Ligës së Parë Grupi B të cilat janë të renditura nga vendi i parë, i dytë dhe i tretë, në fund të edicionit vjeshtor (tabelën sipas rezultateve: vendi i parë, dytë, dhe tretë).**
- b) **Në vazon e dytë do të futen 16 ekipet tjera dhe atë: 14 ekipet e Ligës së Parë të Grupeve A dhe B, të cilat janë të renditura nga vendet 4 – 10 në tabelat e rezultateve të dy grupeve të treguara në fund të edicionit vjeshtor dhe 2 ekipet fituese të ardhura nga ndashjet e rrathëve të zhvilluara nga ekipet e Ligës së Dytë dhe Tretë.**
- c) Ndashjet e të 8-ës, së finales së Kupës së Kosovës; 16 ekipet fituese nga rrethi i zhvilluar (16-ta e finales) që të gjitha do të futen në një vazo dhe do të kenë tërheqje të dirigjuar, dhe nëse dy ekipet e tërhequra për ndashje të zhvilluar në 16-ën, e finales ishin mysafirë, atëherë ekipi i parë i tërhequr me short llogaritet si nikoqir.
- d) dhe e kundërta, nëse dy ekipet e tërhequra për zhvillimin e ndashjës ishin nikoqire, atëherë vlejné rregulli dhe parimi i njëjtë sikurse nën pikën C (ekipi i parë i tërhequr llogaritet nikoqir).
- e) Edhe në ndashjet e Çerek finales, zbatohet i njëjti rregull (short gjysmë i dirigjuar) duke pasur për bazë ndashjet e zhvilluara të ekipeve të tërhequra në short (nikoqir dhe mysafir) nga ndashjet e dy rrathëve të zhvilluara (16-ta, dhe 8-ta, e finales së Kupës së Kosovës në futboll).

Ekipet që mbasin në garë në gjysmëfinale, do të zhvillojnë nga dy ndashje, dhe atë njëherë si nikoqir dhe tjetrën si mysafir (sipas shortit). Në gjysmëfinale ekipi i cili tërhiqet i pari, do të jetë nikoqir në ndashjen e parë, respektivisht mysafir në të dytën.

Ndashja finale e Kupës së Kosovës zhvillohet në kryeqytetin e Republikës së Kosovës në Prishtinë.

Garat për KUPË i udhëheq Komisioni unik për SUPERLIGË dhe Ligën e Parë.

Organi i cili udhëheq me gara, para çdo xhiroje duhet ta tërheq shortin i cili duhet të jetë publik.

### **Neni 71**

Nëse ndeshja për Kupë përfundon pa fitues, luhet në vazhdimë 2 x 15 minuta dhe nëse edhe pas vazhdimëve rezultati është barazi pason ekzekutimi i penalltive sipas rregullave të lojës, për përcaktimin e fituesit.

Ngjashëm veprohet edhe për gjysmëfinale, kur zhvillohen nga dy ndeshje dhe nëse rezultati është plotësisht identik në dy ndeshjet.

Në ndeshjen finale për Kupën e Kosovës, nëse përfundon pa fitues, atëherë për ta përcaktuar fituesin do të zhvillohen vazhdimet 2 x 15 minuta.

Nëse edhe pas vazhimit nuk përcaktohet fituesi, pason ekzekutimi i penalltive sipas rregullave të lojës.

Në ndeshjet e barazhit dhe finalen e KUPËS, shpenzimet e zyrtarëve të ndeshjes i bartin klubet pjesëmarrëse 50% - 50%.

### **Neni 72**

Nëse një ekip nuk paraqitet pa arsye në fushë për ta zhvilluar ndeshjen për KUPËS, atëherë ai ekip do të eliminohet nga garat e mëtutjeshme dhe do të humb të drejtën për të marrë pjesë në garat e Kupës së Kosovës, për dy kampionatet vijuese.

Nëse kjo ngjan në periudhën kur aplikohet sistemi i dyfishtë i ndeshjeve, ekipi që vepron kështu, do të eliminohet nga garat e mëtutjeshme pavarësisht nga rezultati i ndeshjes së parë.

Në mënyrë identike do të veprohet edhe në rastet kur ndeshja ndërpritet dhe regjistrohet me rezultat zyrtarë për njërin ekip. Shkaktari i ndërprerjes eliminohet nga garat e mëtutjeshme, pavarësisht nga rezultati i takimit të parë (nëse është fjala për ndeshjen e dytë).

Nëse këto raste ndodhin në ndeshjen e parë, atëherë ndeshja e dytë nuk zhvillohet fare.

### **Neni 73**

KE i FFK-së, mund të quajë KUPËN e FFK-së, në bazë të Sponsorit eventual dhe për këtë merr vendim të posaçëm. Ndeshja finale e Kupës së Kosovës, do të zhvillohet në stadiumin e kryeqytetit të Kosovës, në Prishtinë, nëse KE nuk vendos ndryshe.

Lidhur me ndarjen e të hollave të realizuara nga shitja e biletave dhe të hyrave tjera (reklama TV etj.), Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, mund të vendos me një vendim të posaçëm.

Pas përfundimit të finales, gjatë ceremonialit të dorëzimit të Kupës skuadrës fituese, skuadra që pëson humbje e ka obligim të qëndron në terren në përbërje complete, në të kundërtën do të ndëshkohet me dënim në para.

### **Neni 74**

Në ndeshjen e "Superkupës" takohen fituesi i Kampionatit (Kampioni) dhe fituesi i Kupës së Kosovës. Organizimin e kësaj ndeshje, si dhe vendin ku do të zhvillohet, përfshirë ndarjen e të hollave të realizuara nga shitja e biletave (nëse ka shitje të biletave) dhe të hyrave tjera (reklama TV etj.), e bënë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Ndeshja e Superkupës e ka tretmanin e ndeshjes kampionale, të edicionit paraprak të garave. Në atë mënyrë trajtohen edhe futbollistët e ndëshkuar (me karton të verdhë apo të kuq) në atë ndeshje.

Pas përfundimit të ndeshjes së Superkupës, gjatë ceremonialit të dorëzimit të Kupës skuadrës fituese, skuadra që pëson humbje e ka obligim të qëndron në përbërje komplete në terren, në të kundërtën do të ndëshkohet me dënim në para.

Në qoftë se, një ekip gjatë një edicioni të garave e fiton edhe titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës, atëherë ndeshja e Superkupës nuk do të zhvillohet fare.

Nëse një ekip nuk paraqitet pa arsye në fushë për ta zhvilluar ndeshjen për SUPER KUPË, atëherë ai ekip do të dënohet në kampionatin e ardhshëm garues dhe do ti merren -3 pike negative në plasmanin e kampionatit respektiv.

Ndeshja e Superkupës nëse përfundon pa fitues, atëherë për ta përcaktuar fituesin do të luhen vazhdimet 2x15 minuta, nëse edhe pas vazhdimëve nuk përcaktohet fituesi, atëherë do të zhvillohen penallti sipas rregullave të lojës.

#### **Neni 75**

FFK-ja, merr përsipër shpenzimet e blerjes së Kupës për fituesin e kampionatit të Kosovës (kampionin), për fituesin e Kupës së Kosovës dhe për fituesin e ndeshjes së Superkupës, nëse me ndonjë vendim tjetër KE nuk ka vendosur ndryshe.

#### **Neni 76**

Në qoftë se ndonjë ekip dënohet me mos lojë në fushën e vetë (vlen edhe për KUPË edhe për Kampionat), atëherë ky ekip duhet të siguroj fushën për ndeshje, e cila duhet të jetë së paku 30 km. larg (rrugë rajonale të asfaltuar) nga stadiumi i saj.

### **XIX. NUMRI MË I VOGËL I LOJTARËVE DHE ZËVENDËSIMET E TYRE**

#### **Neni 77**

Ndeshja nuk mund të filloj nëse njëra prej ekipeve ka më pak se 7 (shtatë) lojtarë.

Lojtarët të cilët nuk e fillojnë ndeshjen, kanë mundësi të futen në lojë deri në fund të ndeshjes, dhe atë në mënyrë të paraparë me këto propozicione të garave, nëse para fillimit të ndeshjes janë shënuar në protokolin e ndeshjes si lojtarë apo rezervistë.

## Neni 78

Nëse një ekip gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes mbetet me më pak se 7 (shtatë) lojtarë (çoftë për shkak të lëndimit, apo përjashtimit, për shkak të mosangazhimit, respektivisht bojkotimit të ekipit apo organit kompetent që udhëheq me gara), gjyqtari i ndeshjes është i obliguar që lojën ta ndërprejë, nëse ekipi nuk është në gjendje që brenda 5 minutave të siguroj numrin minimal (7) të lojtarëve.

Bazuar në raportet e zyrtarëve të ndeshjes, ndaj ekipit dhe individëve të identifikuar si shkaktar kryesor të ndërprerjes së ndeshjes do të iniciohet procedurë disiplinore.

## Neni 79

Në ndeshjet kampionale dhe për KUPË, gjatë lojës mund të ndërrohen më së shumti 3 (tre) lojtarë, në secilin ekip, duke respektuar dispozitat e FIFA-së. Zëvendësimet mund të kryhen vetëm me lojtarë të cilët para ndeshjes janë evidentuar në Protokolin e ndeshjes.

## Neni 80

### XX. ZËVENDËSIMET

Ndryshim i përkohshëm për shkak të rrethanave me pandeminë COVID-19.

Për të gjitha ndeshjet e luajtura në konkurrim zyrtarë (meshkuj dhe femra), ndeshje kampionale dhe të Kupës:

#### 1. Gjatë ndeshjes secili ekip

- Mund të përdor një maksimum prej 5 zëvendësimeve.
- Ka maksimalisht tri ndalesa zëvendësimi.
- Mund të bëjë zëvendësime në pushim, ndërmjet dy pjesëve (nuk llogaritet si ndalesë zëvendësimi).

#### 2. Kur luhet koha shtesë (p.sh. ndeshjet e Kupës) secili ekip

- Mund të përdor një zëvendësim - shtesë (një të gjashtin, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të ndalesave të zëvendësimeve).
- Ka një ndalesë shtesë zëvendësimi (një të katërt, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të ndalesave të zëvendësimit).
- Mund të bëjë zëvendësime shtesë; Në periudhën para fillimit të kohës shtesë dhe në periudhën ndërmjet dy kohëve shtesë.

Nëse një ekip nuk ka përdorur numrin e tij maksimal të zëvendësimeve ose ndalesave të zëvendësimit, zëvendësimet dhe ndalesat e përdorura mund të zbatohen në kohën shtesë.

Kur të dy ekipet bëjnë një zëvendësim në të njëjtën kohë, kjo do të llogaritet si një mundësi zëvendësimi e përdorur për secilin ekip.



Në ndeshjet; U-19, U-17 në njërin ekip mund të zëvendësohen më së shumti 5 lojtarë, kurse në; U-15, U-13 dhe U-11 në njërin ekip mund të zëvendësohen me së shumti 7 lojtarë.

Zëvendësimet mund të kryhen vetëm me lojtarë të cilët para ndeshjes janë evidentuar në protokol – procesverbalin e ndeshjes, dhe ata mund të jenë më së shumti 12 (dymbëdhjetë).

## **XXI. FANELAT**

### **Neni 81**

Ekipet në një ndeshje nuk mund të luajnë me fanela të ngjyrave të njëjta apo të ngjashme. Kompetent për vlerësimin e këtij elementi, është gjyqtari kryesor (pas konsultimit me gjyqtarët ndihmës) i cili edhe e merr vendimin definitiv.

Nëse ekipet, fanelat tradicionale i kanë me ngjyrë të njëjtë apo të ngjashme, atëherë ekipi mysafir është i obliguar që t'i ndërrojë fanelat, në të kundërtën, nëse ndeshja nuk zhvillohet për këtë arsye, ajo do të regjistrohet me rezultat zyrtarë (3:0 Parforfe) në të mirë të ekipit nikoqir.

Para fillimit të kampionatit, me rastin e licencimit në FFK, të gjitha ekipet janë të obliguara ta njoftojnë Komisionin Organizativ të Garave përkatës, për ngjyrën kryesore dhe ngjyrat rezervë të fanelave (tre palë), me të cilat do të luajë në atë kampionat.

Më së voni 15 ditë para fillimit të vitit garues, organi gjegjës i gjyqtarëve të futbollit të FFK-së, është i obliguar të shpallë ngjyrën kryesore dhe ngjyrat rezervë të fanelave.

Ngjyra e paraqitur e fanelave të klubeve, qartas duhet të ndryshojnë nga ngjyra zyrtare e fanelave të gjyqtarëve. Gjyqtarët janë të obliguar që në ndeshje të disponojnë me fanelat rezervë.

### **Neni 82**

**Gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes, lojtarët në pjesën e prapme (shpinë) të fanelave të veta, duhet ti kenë numrat, të dukshëm të madhësisë së caktuar sipas dispozitave me sa vijon:**

- Madhësia-gjatësia e numrave duhet të jetë prej 20 deri 30 cm. kurse gjerësia e vijave të çdo numri duhet të jetë më e vogla 5 cm.
- Numrat në fanela duhet të përputhen me numrat në regjistrin e lojtarëve të shënuar në protokolin e ndeshjes.
- Nëse lojtari përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara me nenin 29, paragrafin 1 të Propozicioneve të Garave, konkretisht identiteti i lojtarit nuk është kontestues, mirëpo eventualisht ndodhë që në protokol zyrtarë të ndeshjes lojtari evidentohet me një numër të caktuar të fanelës, ndërsa në fushë lojtari ka numër tjetër të fanelës, atëherë do të konsiderohet si gabim – lëshim teknik e jo lëshim substancial dhe ndeshja do të regjistrohet me rezultatin e arritur në fushë.

## **XXII. KONTROLLIMI MJEKËSOR I LOJTARËVE**

### **Neni 83**

Afati i vlefshmërisë së kontrollit mjekësor për lojtarë të cilët në ditën e kontrollimit i kanë së paku 17 vjet, zgjatë 6 (gjashtë) muaj.

Me kontrollimin mjekësor special, derisa ai është në fuqi, lojtari i ri (U-17) mund të luajë në të gjitha ndeshjet edhe në rast se e dëshmon me vërtetimin e lëshuar nga qendra e Mjekësisë Sportive.

Klubet janë të obliguara t'i përmbahen në tërësi neneve përkatëse të Rregullores së garave sa i përket kontrollimit mjekësor dhe personelit mjekësor.

## **XXIII. BULETINI ZYRTAR**

### **Neni 84**

Të gjitha Vendimet e organeve të Ligave, shpallen në Ueb faqen e FFK-së, dhe Buletinin zyrtar të FFK-së.

Në buletin zyrtar dhe në Ueb faqen e FFK-së, shpallen vendimet mbi orarin e garave, vendin dhe kohën e zhvillimit të ndeshjeve, si dhe vendimet e tjera me rëndësi për gara.

Vendimet e organeve të garave dhe komisioneve, të cilat i përkasin klubit si tërësi, regjistrimet e ndeshjeve, vendimet mbi dënimet, si dhe vendimet e tjera të organeve që i përkasin garave dhe klubeve, duhet të publikohen në mënyrë që puna dhe rrjedha e garave, të jetë sa më e njohur përmes buletinit zyrtar.

Të gjitha klubet janë të obliguara t'i përfillin vendimet nga Ueb faqja e FFK-së, dhe të "Buletinit zyrtar", t'i përcjellin të gjitha informatat e organeve të ligave, dhe në kërkesë të këtyre organeve ti dërgojnë përgjigjet në afatin e paraparë, në të kundërtën, i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore.

## **XXIV. KUSHTET MINIMALE PËR PUNËN PROFESIONALE – PEDAGOGJIKE**

### **Neni 85**

Të gjitha klubet në bazë të punës së vetë, formojnë kushte për formimin e punës profesional pedagogjike.

Kushtet minimale për punën profesionale pedagogjike në klube, i bëjnë ato kushte të cilat janë dhënë në bazë të Vendimit të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, apo vendimeve të cilat në të ardhmen do të orientohen përmes komisioneve etj.

## **XXV. SHPËRBLIMET**

### **Neni 86**

Kampioni i Kosovës, shpërblehet nga FFK-ja, me Kupë të posaçme, në të cilin do të jetë e gravuar emri i klubit dhe viti i shpalljes së tij Kampion.

## **XXVI. TRANSMETIMET TELEVIZIVE DHE PËRCJELLJA E KAMPIONATIT NGA MJETET E INFORMIMIT**

### **Neni 87**

Me qëllim të informimit mbi rrjedhën e garave, pjesëmarrësit në këtë kampionat të FFK-së, në bashkëpunim me FFK-në, mund të lidhin marrëveshje me qendrën televizive lidhur me transmetimet e ndeshjeve, xhirim të reportazheve, si dhe forma të tjera të informimit përmes TV apo mediave tjera.

KE e FFK-së, mban të drejtën ekskluzive lidhur me të drejtat televizive dhe të lidhura me to. Klubi nikoqir, është i obliguar që gazetarëve, tu mundësoj punën pa kurrfarë pengese, kështu që e gjithë kjo të mundësojë informim të shpejtë, real dhe në shërbim të popullarizimit të futbollit dhe të garave.

Nëse një kontratë e tillë lidhet me ndonjë kompani televizive mes FFK-së, dhe klubeve, atëherë klubet janë të obliguara që t'i përmbahen orarit të garave të përcaktuar nga kompania televizive dhe Komisioni Organizativ i Garave.

## **XXVII. AFATI KALIMTAR I LOJTARËVE**

### **Neni 88**

**Afati kalimtar i lojtarëve të cilët dëshirojnë të kalojnë nga një klub në klubin tjetër të Kosovës, është:**

- Në afati kalimtar dimëror i cili nuk guxon të jetë më i shkurtër së 4 javë dhe,
- Afati i rregullt kalimtar veror i cili nuk guxon të jetë më i shkurtër së 8 javë.
- Datat e sakta i cakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, me vendim të posaçëm, që e merr në kohën e duhur, bazuar në afatet e sugjeruara dhe ato obligative të FIFA-së.

## **XXVIII. OBLIGIMET MATERIALE TË KLUBEVE NDAJ FFK-së, DHE ORGANEVE ZYRTARE**

## **Neni 89**

Klubet e futbollit janë të liruara nga kuotizimet deri në marrjen e ndonjë Vendimi tjetër nga KE, ndërsa Superliga do të quhet sipas kontratës për Sponsorizim të nënshkruar mes FFK-së dhe sponsorit. Klubet janë të obliguara që të respektojnë obligimet e dala nga marrëveshja me sponsorin e Ligës përkatëse.

Të gjitha klubet janë të obliguara të paguajnë anëtarësinë për futbollistët e tyre. Vlera në para rregullohet me Vendim nga KE në fillim të çdo cikli garues. Ky licencim vlen për një kampionat. (5 euro për një ID kartelë).

Në rast të ndërrimit të librezës së lojtarëve (ID Kartelës), shpenzimet e ndërrimit të saj i bartë klubi, qoftë nëse ID Kartela ka humbur apo është dëmtuar apo për arsye të tjera ajo është dashtë me u ndërruar.

Klubet duhet që këto obligime financiare ndaj FFK-së, t'i përmbushin më së voni 15 ditë para fillimit të garave (para stinorit).

## **Neni 90**

Taksat dhe mëditjet për personat zyrtarë gjyqtarë kryesor, anësorë, delegat të ndeshjes, gjyqtare të katërt, vëzhgues i referimit, caktohen me Vendim nga KE i FFK-se, për çdo cikël garues (në fillim të stinorit vijues).

Taksat dhe të gjitha pagesat për Garat e futbollit të femrave dhe të Futsall-it, përcaktohen me Rregullore të veçanta apo me vendim të posaçëm të KE të FFK-së. Shpenzimet e personave zyrtarë iu paguhen përmes llogarisë bankare.

Në rast se ekipi nuk i paguan personat e deleguar, nuk i delegohen zyrtarët për ndeshjet e ardhshme dhe të njëjtën e humb me rezultat zyrtarë Parforfe (3:0).

Nëse ndeshja nuk ka përfunduar me kohë siç e parashikojnë dispozitat e këtyre Propozicioneve dhe e njëjta përsëritet, shpenzimet e personave zyrtarë i paguan ekipi nikoqir, ndërsa shpenzimet e rrugës së ekipit mysafir i paguan vet ekipi mysafir.

Kur kërkesën për kontroll të posaçme e bënë klubi, atëherë shpenzimet për personin zyrtarë e bënë (pagan) klubi i cili ushtron një kërkesë të tillë, dhe atë në emër të mëditjes, ndërsa taksat për ndeshjet e Superligës dhe të Ligës së I-rë, ligës se II-të, caktohen me Vendim nga KE në fillim të ciklit të garave.

Në rast të mos zhvillimit të ndeshjes, personave zyrtarë të ndeshjes (delegatit, gjyqtarëve eventualisht kontrollorit) ekipi nikoqir duhet t'ua paguaj 50 %, e mëditjes.

## **Neni 91**

### **XXIX. TAKSAT DHE MEDITJET PËR ZYRTARËT E NDESHJEVE**

- a) SUPERLIGA; SENIORËT

<b>Nr.</b>	<b>Pozita</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Delegati i ndeshjës	100.00 €
<b>2</b>	Gjyqtari kryesorë	200.00 €
<b>3</b>	Asistenti i parë	150.00 €
<b>4</b>	Asistenti i dytë	150.00 €
<b>5</b>	Gjyqtari i katërt	100.00 €
<b>6</b>	Vëzhguesi i referimit	80.00 €

b) LIGA E PARË – SENIORËT

<b>Nr.</b>	<b>Pozita</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Delegati i ndeshjës	90.00 €
<b>2</b>	Gjyqtari kryesorë	150.00 €
<b>3</b>	Asistenti i parë	120.00 €
<b>4</b>	Asistenti i dytë	120.00 €
<b>5</b>	Vëzhguesi i referimit	70.0 €

LIGA E DYTË – SENIORËT

<b>Nr.</b>	<b>Pozita</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Delegati i ndeshjës	80.00 €
<b>2</b>	Gjyqtari kryesorë	100.00 €
<b>3</b>	Asistenti i parë	80.00 €
<b>4</b>	Asistenti i dytë	80.00 €

a) JUNIORËT; SUPERLIGA- LIGA E PARË - KADETËT (NIVELI NACIONAL)

<b>Nr.</b>	<b>Pozita</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Delegati i ndeshjës	40.00 €
<b>2</b>	Gjyqtari kryesorë	40.00 €
<b>3</b>	Asistenti i parë	30.00 €
<b>4</b>	Asistenti i dytë	30.00 €

LIGA E TRETË (Seniorët)

<b>Nr.</b>	<b>Pozita</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Delegati ndeshjës	60 €
<b>2</b>	Gjyqtari kryesorë	70 €
<b>3</b>	Asistenti parë	60 €
<b>4</b>	Asistenti dytë	60 €

b) LIDHJET RAJONALE; GRUPMOSHAT E REJA

<b>Nr.</b>	<b>Pozita</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Delegati i ndeshjës	30.00 €
<b>2</b>	Gjyqtari kryesorë	30.00 €
<b>3</b>	Asistenti i parë	30.00 €
<b>4</b>	Asistenti i dytë	30.00 €

c) **MEDITJET PËR NDESHJET E PA ZHVILLUARA**

<b>Nr.</b>	<b>Niveli garues</b>	<b>Udhëtimi</b>	<b>Mëditja</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>1</b>	Superliga; Seniorët	10.00		
<b>2</b>	Liga e parë; Seniorët	10.00		
<b>3</b>	Juniorët; Superliga	10.00		
<b>4</b>	Juniorët; Liga e parë	10.00		
<b>5</b>	Kadetët (nacional)	10.00		

**Neni 92**

Nëse lojtari ndëshkohet me karton të kuq apo me dy kartonë të verdhë brenda një ndeshjeje (kartoni i kuq), atëherë ekipi i tij ndëshkohet me të holla, sipas Vendimit nga KE me të cilin rregullohet shuma e kartonit të kuq direkt, 2 kartonëve të verdhë, kartonit të verdhë.

**Neni 93**

Pasqyrë e pagesës së kartonëve sipas niveleve dhe rangjeve garuese;

<b>Nr.</b>	<b>Niveli garues</b>	<b>2 KV ( KARTONI I KUQ)</b>	<b>KARTONI I KUQ</b>
<b>1</b>	Superliga – Seniorët	100 €	200 €
<b>2</b>	Liga e parë – Seniorët	80 €	160 €
<b>3</b>	Liga e dytë – Seniorët	50 €	100 €
<b>4</b>	Juniorët – Superliga	30 €	50 €
<b>5</b>	Juniorët – Liga e parë	20 €	50 €
<b>6</b>	Kadetët ( niveli nacional )	20 €	50 €
<b>7</b>	Liga e tretë	30 €	50 €
<b>8</b>	Grup moshat e reja; 11 - 13 - 15	10 €	20 €

**Neni 94**

Nëse trajneri, largohet nga bankina (hapësira teknike), ekipi i tij do të dënohet me shumë të cilën e përcakton KE, sipas Vendimit të marrë në fillim të ciklit të garave.

	<b>Emërtimet e pozicioneve</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Trajneri - Superligës - Seniorët	300 €
<b>2</b>	Trajneri Ligës së parë - Seniorët	200 €
<b>3</b>	Trajneri Ligës së dytë - Seniorët	100 €
<b>4</b>	Trajneri juniorëve (Superliga dhe	50 €
<b>5</b>	Trajneri kadetëve (niveli nacional)	50 €
<b>6</b>	Liga e tretë	50 €
<b>7</b>	Trajneri në grup moshat e reja (L.	50 €

### **Neni 95**

Nëse anëtarët e udhëheqësisë së klubeve, (funksionarët, udhëheqësit profesional dhe teknik, drejtorët dhe personat që kryejnë funksione të tjera në klub), kryejnë çfarëdo kundërvajtje në garat e futbollit dhe lidhur me garat e futbollit, atëherë klubet e tyre do të dënohen me gjobë sipas Rregullores Disiplinore, varësisht nga rangu i garave dhe pesha e veprës.

Nëse brenda një stinori (vjeshtë apo pranverë), i njëjti futbollist, trajner apo punëtor sportiv, e përsëritë deliktin për të cilin dënohet sipas dispozitave të alineve të lartë theksuara të këtij neni, atëherë, lartësia e dënimit të tij dyfishohet. Klubet detyrohen që të i përmbushin kërkesat që mund të dalin nga departamenti për integritet sportiv, siç është edukimi (trajnimet kundër kurdishjes), në pajtueshmëri me Rregulloren Disiplinore, e të cilat paraqesin detyrim nga UEFA.

Në rast se ekipet nuk i përmbushin detyrimet e përcaktuara dhe kërkuara nga departamenti për integritet sportiv, atëherë Komisioni Organizativ i Garave do të iniciojë procedurë tek Komisioni Disiplinor dhe i Etikës ndaj klubeve të cilat nuk i kanë përmbushur detyrimet.

### **Neni 96**

Secili ekip është i obliguar, që para zhvillimit të ndeshjes së xhiros në rradhës, t'i paguaj FFK-së, të gjitha dënimet në të holla, për kartuça të kuq si dhe dënimet tjera në të holla që ia kanë shqiptuar organet kompetente të FFK-së, (kur vendimet bëhen të plotfuqishme), në të kundërtën, ky ekip do të pezullohet (nuk ka të drejtë loje) nga garat e ardhshme.

Të gjitha obligimet financiare ndaj FFK-së, që rrjedhin nga Rregullorja e Propozicioneve, duhet të kryhen në xhirollogarinë zyrtare të FFK-së.

### **Neni 97**

#### **Pagesat e transferimeve**

<b>Nr.</b>	<b>Nivelet e garimit sipas kategorive</b>	<b>Shuma</b>
<b>1</b>	Transferimi në Superligë – vendor	100 €
<b>2</b>	Transferimi në Superligë – i jashtëm	200 €

<b>3</b>	Transferimi në Ligën e parë – vendos	80 €
<b>4</b>	Transferimi në Ligën e parë ( meshkuj dhe femra ) i jashtëm	200 €
<b>5</b>	Transferimi në ligën e dytë	50 €
<b>6</b>	Transferimi në ligat e Juniorëve	30 €
<b>7</b>	Transferimi në Ligën e Kadetëve	30 €
<b>8</b>	Liga e tretë	30 €
<b>9</b>	Transferimet në kategoritë e reja; 11-13-15	20 €

### **XXX. MARKETINGU**

#### **Neni 98**

##### **- Sponsorët në fanellë**

Vetëm sponsorët e aprovuar ng FFK, mund të vendosen në fanellën e lojës.

Klubet mund te ndryshojnë sponsoret ne fanelle gjate sezonit vetem ne here gjate nje sezoni.

Fillimi i sezonit pa nje sonsor ne fanelle nuk konsiderohet ndryshim.

Ndryshimi i përmbajtjes (formes /logos) ndonëse sponsori është i njejtë do të konsiderohet ndryshim.

Klubet të cilat kërkojnë të ndryshojnë sponsorin në fanellë duhet të deponojnë në FFK kërkesën të paktën 7 (shtatë), ditë përpara ndeshjes gjatë të cilës dëshirojnë të shfaqin sponsorin e ri.

Parashikimet e këtij neni vlejné edhe për sponsorët pse reklamat në uniformat e stërviitjes.

##### **- Stemat**

Përgjatë gjithë ndeshjeve zyrtare, stema e ALBI MALL Superliga duhet të shfaqet në mëngën e djathë të fanellës së lojës.

### **XXXI. SHFRYTËZIMI I TË DREJTAVE TREGTARE**

#### **Neni 100**

Nga pikëpamja e marketingut, është detyrë e FFK-së të përmbush qëllimin statutor për zhvillimin e futbollit në Kosovë duke forcuar pozicionin e këtij sporti në shoqërinë shqiptare. Mundësitë tregtare dhe financiare përdoren në dobi të zhvillimit gjatë futbollit duke respektuar rregullat e tregut.

#### **Neni 101**

##### **Të drejtat tregtare**

- FFK është pronare ekskluzive dhe përfituese e të gjitha të drejtave tregtare.
- Në përputhje me statutin, FFK rezervon çdo të drejtë tregtare dhe industriale për të shfrytëzuar dhe shpërndarë ardhurat prej shfrytëzimit të këtyre të drejtave.

##### **Shfrytëzimi i të drejtave tregtare të garës**

- a) Të drejtat lidhur me median
  - b) Të gjitha të drejtat e lidhura me median mbi garat e organizuara nga FFK, shfrytëzohen nga FFK.
  - c) Të drejtat te tjera tregtare - sponsori i ligës.
- FFK gëzon të drejtën ekskluzive për të shfrytëzuar të gjitha të drejtat e tjera tregtare dhe për të bashkëpunuar me partner/ sponsor përgjatë garës.



- Partnerët apo sponsorët mund të kenë të drejtë ekskluzive për të shfrytëzuar të drejta të caktuara.
  - Klubet obligohen të ndjekin në përpikmëri manualin e marketingut dhe çdo mos-përmbushjen e detyrimeve nga ana e tyre do të sanksionohet nga Komisioni Disiplinor dhe i Etikës.
- d) Të drejtat e klubeve pjesëmarrëse në garë;
- Klubet mund të shfrytëzojnë disa të drejta mediatike në përputhje me këtë rregullore.
  - Klubet gëzojnë të drejtën e shfrytëzuar fragmente (highlights) nga ndeshjet e tyre të cilat vendosen në sdispozicion nga FFK ose të prodhojnë fragmentet në ndeshjet e tyre (maksimumi një kamerë dhe pas aprovimit me shkrim të FFK-së), për ta përdorur për qëllimet e tyre si analiza stërvitore etj.
- e) Të drejtat mbi të dhënat statistikore
- FFK mund të shfrytëzojë të dhënat statistikore të garës, përfshirë të gjitha ndeshjet dhe të autorizojë palët e treta për këtë qëllim.
  - Klubet mund të përpilojnë të dhëna statistikore për ndeshjet e tyre në garë për t'i përdorur për qëllimet e tyre duke pasur të drejtën t'i publikojnë këto të dhëna.
  - Klubet duhet të garantojnë se të dhënat statistikore nuk do të shiten dhe se asnjë palë e tretë nuk mund të asociohet me garën e organizuar nga FFK.
  -

### **Të drejtat tregtare**

- Partnerët dhe /ose sponsorët e FFK-së dhe ose klubeve pjesëmarrëse gëzojnë të drejtën ekskluzive për të drejtën ekskluzive për të shfrytëzuar nga ana tregtare dhe promocionale garën e Superliga, Liga e Parë, Liga U 21 dhe Liga e Dytë. Të gjitha emrat, termat, simblet, llogot, maskotat dhe/ose format e tjera artistike, grafike e muzikore lidhur me garën mund të përdoren vetëm nga partnerët dhe/ose sponsort për qëllimet e tyre tregtare me aprovimin e FFK-së.
- Klubet pjesëmarrëse në garën e Superliga, Liga e Parë, Liga U 21, Liga e Dytë, marrin përsipër të garantojnë suportin maksimal për FFK-në, në mënyrë që të implementohen të drejtat tregtare të parashikuara në këtë rregullore.
- Klubet pjesëmarrëse në garën e Superliga U 21, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të mbrojtur imazhin e garës duke penguar dhe ndaluar çdo veprim që cënon vlerën.

## **XXXII. MARDHËNIET ME MEDIAT**

### **Neni 102**

#### **Përgjegjësitë lidhur me çështjet e medias**

- Çdo klub duhet të emërojë një person përgjegjës për median i cili të koordinojë bashkëpunimin mes klubit, FFK dhe medias. Përgjegjësi i medias duhet të sigurojë se ambientet e medias të jenë në gjendje pune dhe konform rregullores së infrastrukturës si dhe të koordinojë të gjitha aktivitetet e lidhura me ndeshjen nga pikëpamja mediatike.
- Përpara fillimit të çdo sezoni, klubet duhet t'i vendosin në dispozicion FFK-së, të dhënat dhe fotografitë e lojtarëve dhe trajnerit kryesor si dhe fotografi historike të stadiumeve apo të dhëna të tjera për qëllime promocionale.

#### **Aksesi i mediave**

- Dhomat e zhveshjes nuk mund të aksesohen nga media, me përjashtim kur klubi dhe FFK, dakordësojnë ndryshe.
- Asnjë përfaqësues i medias nuk lejohet të hyjë në hyjë në fushën e lojës përpara gjatë dhe pas ndeshjes me përjashtim të ekipit të kameramanëve gjatë rreshtimit të ekipeve.
- Të gjithë përfaqësuesit e medias, përfshirë fotografët, gazetarët, kameramanët etj, duhet të detyrimisht të jenë të pajisur me akreditimin përkatës për të hyrë në stadium.

#### **Hapësirat e punës për mediat**

- Klubet duhet të vendosen në dispozicion një hapësirë të posaçme pune për përfaqësuesit e kredituar të medias në përputhje me rregulloren e infrastrukturës së FFK-së.

#### **Hapësirat e punës për transmetuesit audio vizual**

- Klubet duhet të krijojnë infrastrukturën e nevojshme për transmetuesit audio vizual të garës duke përfshirë asistencën teknike, energjinë elektrike, pozicionet e vendosjes së kamerave etj.

### **XXXIII. DISPOZITAT KALIMTARE**

#### **Neni 103**

Çdo vendim që merret në përputhje me këto Propozicione të Garave, është obligativ për të gjithë, derisa dispozitat e këtyre Propozicioneve të mos ndryshojnë.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve i bënë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, në procedurën e njëjtë si për aprovimin e tyre.

#### **Neni 104**

Për çështjet që nuk janë përfshirë në këto Propozicione, vlejnjë Rregullorja e Garave, Rregullorja Disiplinore, aktet tjera normative të FFK-së, si dhe Rregullat e lojës së futbollit, të UEFA-së dhe FIFA-së.

#### **Neni 105**

Këto Propozicione u miratuan me datë 04 Korrik 2023. Propozicionet e Garave hyjnë në fuqi ditën e ardhshme pas nënshkrimit të saj.

**Prishtinë, 04 Korrik 2023**

**Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së,**

**Agim Ademi**